

**RAPORT**  
**“AKTIVITETI I SHOQËRISË KESH SH.A. PËR VITIN 2023”**

**Shkurt 2024**

TABELA E PËRMBAJTJES

<b>AKRONIME</b> .....	<b>3</b>
<b>1. SITUATA NË TË CILËN SHOQËRIA USHTROI VEPRIMTARINË E SAJ PËR 2023</b> .....	<b>4</b>
<b>2. ZHVILLIMET KRYESORE TË AKTIVITETIT DHE NGJARJE TË 2023</b> .....	<b>5</b>
2.1 SITUATA E TREGJEVE TË ENERGISË DHE DIVERSIFIKIMI.....	5
2.2 BURSA SHQIPTARE E ENERGISË (ALPEX) .....	7
2.3 MASAT PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË FUNIZMIT ME ENERGI.....	7
2.4 PROGRAMI EKONOMIKO-FINANCIAR I KESH SH.A. PËR VITIN 2023.....	8
2.4 PËRMBLEDHJE E SITUATËS HIDRIKE.....	11
2.5 TË DHËNAT KRYESORE OPERATIVE TË AKTIVITETIT TREGTAR DHE EKONOMIK.....	13
2.6 KOMERCIALIZIMI I MËTEJSHËM I AKTIVITETIT .....	15
<b>3. ZHVILLIME LIGJORE/RREGULLATORE TË LIDHURA ME AKTIVITETIN 2023</b> .....	<b>16</b>
3.1 ZHVILLIME LIGJORE .....	16
3.2 ZHVILLIME RREGULLATORE .....	17
<b>4. AKTIVITETI PRODHUES, MIRËMBAJTËS DHE EFIÇENCA NË SHFRYTËZIM</b> .....	<b>22</b>
4.1 PRODHIMI I ENERGISË ELEKTRIKE – OPERIMI.....	22
4.2 SIGURIA E VEPRAVE HIDROTEKNIKE .....	26
4.3 MIRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I AGREGATEVE .....	27
4.4 CILËSIA E PRODHIMIT .....	30
<b>5. BILANCI ENERGETIK DHE AKTIVITETI TREGTAR PËR VITIN 2023</b> .....	<b>31</b>
5.1 ANALIZA E BILANCIT ENERGETIK .....	31
5.2 AKTIVITETI NË PLOTËSIMIN E DSHP .....	33
5.3 AKTIVITETE TREGTARE TË TJERA .....	36
<b>6. AKTIVITETI INVESTUES 2023</b> .....	<b>40</b>
6.1 REALIZIMI I INVESTIMEVE.....	40
6.2 INVESTIMET E ME FONDET E HUAJA .....	43
6.3 INVESTIMET ME FONDET E VETA .....	44
6.4 ECURIA E PROJEKTEVE BRË.....	45
<b>7. AKTIVITETI EKONOMIKO-FINANCIAR PËR VITIN 2023</b> .....	<b>46</b>
7.1 AKTIVITETI I OPERACIONEVE TË VIJUESHËM .....	46
7.2 MARRËDHËNIET BRENDA SEKTORIT ELEKTROENERGETIK .....	50
<b>8. KONKLUZIONE</b> .....	<b>54</b>

## AKRONIME

<b>ACER</b>	- The European Union Agency for the Cooperation of Energy Regulators
<b>APA</b>	- Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të KESH sh.a.
<b>ALPEX</b>	- Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
<b>BB</b>	- Banka Botërore
<b>BERZH</b>	- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>BRE</b>	- Burimet e Rinovueshme të Energjisë
<b>DAM</b>	- Tregu i Ditës në Avancë (Day Ahead Market)
<b>DSHP</b>	- Detyrimi për Shërbim Publik
<b>EIP</b>	- Plani i Investimeve Ekonomike të Bashkimit Europian në Ballkanin Perëndimor
<b>ERE</b>	- Enti Rregullator i Energjisë
<b>FMF</b>	- Furnizuesi i Mundësisë së Fundit
<b>FTL</b>	- Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.
<b>FSHU</b>	- Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.
<b>HUPX</b>	- Bursa Hungareze e Energjisë
<b>HUDEX</b>	- Bursa Hungareze e Derivateve të Energjisë
<b>IDM</b>	- Tregu brenda Ditës (IntraDay Market)
<b>IRENA</b>	- International Renewable Energy Agency
<b>KESH</b>	- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., ose në vijim Korporata/Shoqëria
<b>KfW</b>	- Banka Gjermane e Zhvillimit
<b>KOSTT</b>	- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
<b>MFE</b>	- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>MIE</b>	- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>NEMO</b>	- Nominated Electricity Market Operator (Bursa e Energjisë)
<b>OST</b>	- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike sh.a.
<b>OSHEE Grup</b>	- Grupi Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
<b>OSSH</b>	- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
<b>PEF</b>	- Programi Ekonomiko-Financiar i KESH sh.a.
<b>PPE</b>	- Prodhuesit me Përparësi të Energjisë
<b>REMIT</b>	- Rregullore për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë
<b>SECO</b>	- Sekretariati Shtetëror i Çështjeve Ekonomike i Zvicrës
<b>ViD</b>	- Vau i Dejës
<b>WBIF</b>	- Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor

## 1. SITUATA NË TË CILËN SHOQËRIA USHTROI VEPRIMTARINË E SAJ PËR 2023

Viti 2023 u karakterizua si një vit aktiviteti intensiv për Korporatën, por edhe për zhvillimet e sektorit elektroatenergjetik në tërësi. Edhe gjatë 2023, veprimtaria e KESH sh.a., u zhvillua në vazhdim situatës të emergjencës së furnizimit me energji elektrike, e cila me VKM nr. 449; dt. 26.07.2023, zgjati afatin e saj deri në 31 Dhjetor 2023. Në lidhje me situatën globale, historikisht, tregjet e energjisë, kanë pasur luhataje të vogla të çmimeve, kryesisht si rezultat i efekteve sezonale të njohura dhe të pritshme, të cilat ndikonin në ndryshimin e ekuilibrit të brendshëm të kërkesë-ofertës. Mjafton të përmendim faktin që për periudhën 2010-2020, çmimet mesatare base-load (ref. HUPX), varionin pothuajse në segmentin 40 Eur/MWh - 50 Eur/MWh, duke krijuar stabilitet global afatgjatë dhe psikozën e “pacënueshmërisë” së këtij trendi. Ndërkohë, që ky stabilitet afatgjatë, u trondit në mesin e 2021, me amplituda rritje të menjëhershme dhe të pazakonta të çmimit të energjisë, i cili mesatarisht për 2021, për të njëjtin tregues base-load shënoi 113.6 Eur/MWh. Rritja galopante e çmimeve të energjisë u thellua në 2022, ku treguesi base-load shënoi vlerën mesatare vjetore prej 270.4 Eur/MWh, duke e kthyer krizën në realitet jo afatshkurtër.

Gjithsesi, gjatë vitit 2023, çmimi i energjisë shënoi gradualisht rënie, duke u stabilizuar rreth mesatares  $\pm 100$  Eur/MWh, duke lehtësuar presionin mbi ekonominë globale, veçanërisht atë europiane. Ky ndryshim në kah pozitiv i situatës globale të çmimeve të energjisë, ndikoi edhe tek Korporata pasi ul ndjeshëm ekspozimin ndaj riskut të tregjeve, në rast importi të energjisë.

Në aspektin e brendshëm, Korporata e zhvilloi aktivitetin operativ, nën një situatë të favorshme hidro-meteorologjike (ndryshe nga 2022), duke reflektuar tregues pozitiv në performancën e operim-shfrytëzimit dhe menaxhimit energjetik të kaskadës së Drinit.

Në aspektin sektorial kombëtar, janë shënuar hapa mjaft të rëndësishëm në ecurinë e reformave transformuese drejt liberalizimit të tregut. Ngjarja kryesore me impakt sektorial dhe kombëtar, është çelja zyrtare Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX), prej 11 Prill 2023, duke filluar tregtimin e energjisë në tregun e ditës në avancë (DAM). Në objektivi të ALPEX janë implementimi së shpejti i tregtimit të energjisë në tregun brenda ditës (IDM), si dhe unifikimi i tregjeve të energjisë Shqipëri-Kosovë në ALPEX.

Në vijim të përballimit të gjendjes së emergjencës edhe gjatë 2023, Korporata e përqëndroi veprimtarinë operacionale në sigurimin e volumeve të energjisë në funksion të përmbushjes së objektivit për furnizim për Detyrimin për Shërbim Publik (DSHP), pra me aktivitet kryesor në tregun e rregulluar. Rrjedhimisht ky aktivitet i pasqyruar në Programin Ekonomiko-Financiar për 2023, u përgatit dhe u aplikua me fokus prioritar në këtë veprimtari. Pavarësisht kësaj, Korporata zhvilloi edhe aktivitetet e tjera, kryesisht ato komerciale me objektivi rritjen e përfitueshmërisë nga aktiviteti tregtar dhe ato investuese me objektiva si: rritja e sigurisë/efiçencës së asetëve gjeneruese dhe zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë, nëpërmjet shtimit të diversifikuar të BRE.

Referuar situatës me çmimeve të energjisë më të moderuara dhe të stabilizuara dhe situata pozitive hidrike, viti 2023, shpalosi një aktivitet operativ pozitiv për Korporatën dhe në kontrast me vitin e vështirë 2022. Po kështu masat e marra e gjetën Shoqërinë edhe më të përgatitur, në përballimin e gjendjes së emergjencës. Në vija të përgjithshme, ecuria pozitive në 2023, tregon aftësinë/potencialin e lartë reagues dhe rikuperues që bart Korporata, në përballimin e situatave të tilla, veçanërisht atë të rritjes galopante të çmimeve të energjisë në tregje globale.

Gjithsesi, kjo ecuri pozitive e 2023 në kontrast me 2022, tregoi përsëri se portofoli gjenerues aktiv pothuajse 100% hidro, shfaq varësitë të ndjeshme të aktivitetit operacional të Shoqërisë ndaj kushteve hidro-meteorologjike, duke ndikuar direkt në gjenerimin e brendshëm dhe rrjedhimisht edhe në masën e ekspozimit ndaj tregjeve/importit, për plotësuar sasinë e energjisë në funksion të përmbushjes së DSHP.

Korporata, në aktivitetin e saj, edhe gjatë vitit 2023, ka pasur mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, dhe veçanërisht të MIE si në aspektin ligjor/rregullator duke i dhënë instrumentat përkatës, por edhe financiar, me objektivi themelor sigurimin e energjisë për konsumatorin final nëpërmjet plotësimit me çdo kusht të detyrimit për shërbimin publik në tregun e rregulluar të energjisë dhe njëkohësisht duke marrë përsipër edhe barrën financiare, për mbrojtur konsumatorin familjar dhe biznesin, duke mbajtur të njëjtin çmim të rregulluar të pandryshuar.

Gjerësisht dhe në mënyrë më të detajuar mbi këto çështje do të flitet në vijim të këtij dokumenti.


## 2. ZHVILLIMET KRYESORE TË AKTIVITETIT DHE NGJARJE TË 2023

Referuar panoramës së përgjithshme të përshkruar në paragrafin e mëparshëm, ndër zhvillimet kryesore, të cilat ndikuan në performancën e aktivitetit operacional-ekonomik të Korporatës gjatë 2023, mund të renditim në vijim:

### 2.1 SITUATA E TREGJEVE TË ENERGJISË DHE DIVERSIFIKIMI

Rritja e kërkesës për energji shkaktuar si kombinim i rritjes së aktivitetit global ekonomik post-pandemik dhe situatës gjeopolitike në Evropë (konflikti Rusi-Ukrainë), shkaktuan një rritje të çmimeve të lëndëve djegëse dhe veçanërisht të gazit natyror, naftës dhe qymyrit. Kjo rritje, ndikoi në rritjen e çmimit të energjisë elektrike në bursat ndërkombëtare dhe sidomos në tregun evropian. Më poshtë paraqitet grafikisht kurba e çmimit mesatar mujor të energjisë, sipas Bursës Hungareze (HUPX) në mbyllje pozicioni (ATC-At The Close Order).

Grafiku 1. Çmimi mesatar mujor 2023-HUPX




Pas vitit të vështirë 2022, ku çmimet e energjisë në tregje njohën rritjen më të madhe, viti 2023, fillon me vlera në rënie muaj pas muaji dhe, pas muajit Maj 2023 ato shfaqin një lloj stabiliteti rreth vlerës 100 Eur/MWh. Edhe grafikisht pasqyrohet kjo tendencë ulje, ku nga niveli mesatar prej 148.69 Eur/MWh në Janar, treguesi mesatar base-load në Dhjetor zbritet në 81.72 Eur/MWh (-45%). Niveli mesatar vjetor 2023 shënon vlerën 107 Eur/MWh. Krahasuar me mesataren e vitit 2022 prej 270.43 Eur/MWh, ulja është e ndjeshme mbi 2.5x, duke i dhënë frymëmarrje tregjeve të energjisë elektrike, dhe rrjedhimisht edhe ekonomive, veçanërisht atyre evropiane. Pas goditjes që pësuan tregjet energjitike në mesin e vitit 2021 dhe që kulmuan në vitin 2022, ekonomitë botërore dhe veçanërisht ato evropiane, morrën masa në terma makro dhe mikro ekonomik, për përballimin e kësaj situatë, duke përshtatur ekonomitë e tyre, drejt uljes së varësisë dhe ekspozimit ndaj furnizimit me lëndë të para energjitike nga Rusia (veçanërisht gazit natyror). Kjo u arrit duke krijuar rezerva afatgjata në këto lëndë dhe duke rikonfiguruar tregje të reja për furnizim. Këto masa dhanë efekt në uljen dhe stabilizimin e çmimeve të energjisë gjatë 2023. Aktualisht, ky indeks për periudhën Janar-Shkurt 2024, ka zbritur në mesataren 78.63 Eur/MWh.

Përsa i përket së ardhmes afatshkurtër, referuar të dhënave të HUDEX mbi kontratat derivative të së ardhmes, aktualisht parashikohet që indeksi baseload për periudhën 2024-2025 të jetë më së shumti brenda fashës 60-80 Eur/MWh, duke projektuar stabilitet në çmimet e energjisë. Gjithsesi edhe këto parashikime janë mjaft evazive, pasi situata delikate gjeopolitike, veçanërisht vazhdimi i konfliktit Rusi-Ukrainë, krijon pasiguri të lartë në projeksione.

Ndërkohë, në terma afatmesëm dhe afatgjatë, jo vetëm risku ndaj ndryshimeve klimatike por edhe ulja e varësisë ndaj lëndëve të para energjitike ruse (veçanërisht në Europë), ka rritur më tepër presionin dhe fokusin në përshpejtimin e realizimit të projekteve BRE në rang global, në përpjekje dhe me synim

ristrukturimin e kapaciteteve gjeneruese dhe konsumit të energjisë të pastër/gjelbër, në rrugën drejt heqjes së prodhimit dhe konsumit të energjisë me bazë fosile/hidrokarbure, për të arritur objektivat e “COP28 climate target”, mbi trefishimin e kapaciteteve BRE deri në 2030.

**Grafiku 2. Kapacitetet totale globale aktive BRE (GW)**



Referuar IRENA/grafikut të mësipërm, në rang global, totali kapaciteteve të instaluar BRE nga 1.22 TW në 2010, arriti në rreth 3.89 TW në fund të 2023, me rritje gati 3.2x. Vërehet që rritja/shtesa më e madhe vjetore në kapacite BRE, është ajo e vitit 2023, me 507 GW (+15%). Për më tepër, nga kjo shtesë prej 507 GW në 2023, rreth 75% të saj e përbëjnë kapacitetet BRE të teknologjisë PV/Solar.

Vlen për tu theksuar se, bazuar portofolit kombëtar të prodhimit të energjisë elektrike dhe strategjisë kombëtare të ndjekur nga Qeveria mbi shtimin dhe diversifikimin e BRE, referuar EuroStat, Shqipëria renditet e 3-ta në Europë (pas Suedisë dhe Finlandës), në indikatorin e raportit ndërmjet konsumit të energjisë që prodhohet nga BRE kundrejt konsumit total të energjisë (energji elektrike, karburantet, etj.).

Ky tregues për Shqipërinë është 44%, ndërkohë që mesatarja e BE-së është 23%.

Në këtë tregues mjaft pozitiv për vendin, kontributin kryesor e zë KESH, si prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në vend, dhe që mban peshën kryesore në konsumin kombëtar të energjisë, i cili falë portofolit të gjenerimit tërësisht BRE, prodhon 100% energji të pastër/të gjelbër.

Për më tepër, referuar direktivës së rishikuar të BE-së për energjinë e rinovueshme 2018/2001 (RED II), kjo vlerë dhe avantazh i cilësisë së prodhimit të energjisë së pastër është materializuar nga KESH, nëpërmjet Garancisë së Originës të prodhimit. Në këtë kuadër gjatë 2023, ERE (me kërkesë të KESH), ka pajisur zyrtarisht HEC-et e kaskadës dhe impiantin PV Diga e Qyrzaqit ViD me çertifikatat e Garancisë së Originës për prodhimin e energjisë së pastër. Garancitë e Originës, në kuptimin komercial vlerësohen edhe ekonomikisht duke qenë të tregtueshme sipas procedurave të tregtimit të energjisë elektrike, duke sjellë përfitim ekonomik-tregtar për shoqërinë poseduese, të cilën KESH po e aplikon.

## **2.2 BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË (ALPEX)**

Më 11 Prill 2023, nisi operimin zyrtar Bursa Shqiptare e Energjisë - ALPEX, përmes ankandit të parë të tregut të ditës në avancë (DAM), duke realizuar një nga përparësitë e Qeverisë së Shqipërisë për sektorin energjistik. Kjo është një ngjarje e shënuar për sektorin e elektroenergjitik në tërësi dhe Korporatën në veçanti, si aktor kryesor në treg. Për më tepër operimi i ALPEX përfaqëson një angazhim të Shqipërisë të ndërmarrë kundrejt Sekretariatit të Komunitetit Europian të Energjisë.

ALPEX është bursa e dytë operationale në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6) dhe erdhi si një domosdoshmëri për të garantuar transparencë, konkurrencë dhe përdorim efikas të kapaciteteve, të cilat po shtohen e do të shtohen gjithnjë e më shumë, falë një sërë investimesh të reja apo të tjerave në vijim. Ajo do të ndihmojë sipërmarrjet prodhuese të Shqipërisë dhe Kosovës, për të gjetur energji elektrike me çmim më të lirë në këtë bursë. Bursa përdor algoritmin (platformën) EUPHEMIA (miratuar nga ACER me vendimin 4/2020), e cila aplikohet në NEMO-t mbarëevropiane:

Avantazhet e tregtimit nëpërmjet ALPEX janë:

- Integron tregun shqiptar me tregun evropian të energjisë;
- Do të gjejë energji elektrike me çmim më të lirë se importi i paorganizuar në bursë;
- Do të ulë kostot dhe kohën që duhet për të gjetur shitës dhe blerës jashtë kufijve të Shqipërisë;
- Do të krijojë treg konkurrues të energjisë;
- Do të sigurojë më shumë transparencë të kontratave të shitblerjes së energjisë elektrike, për përdoruesit e vendit. Të gjithë do të kuptojnë teknikisht si shitet dhe blihet energjia;
- Do të bashkojë tregun e ditës në avancë me tregun brenda ditës (çmimi i energjisë në orën pik ndryshon me çmimin e paradites ose nates).

Në vijim të aktivitetit të ALPEX, tregjet e energjisë të Shqipërisë dhe Kosovës unifikohen në ALPEX. Gjithashtu aktiviteti i ALPEX do të njohë nivel dhe dinamikë tjetër, pasi së shpejti do të implementojë edhe opsionin/procedurën intraday (IDM) për tregtim të energjisë elektrike.

## **2.3 MASAT PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË FUNIZIMIT ME ENERGJI**

Me qëllim përballimin dhe parandalimin e krizës së energjisë elektrike në Europë dhe më gjerë, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë me anë të VKM nr 584, datë 08.10.2021 “Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike” i ndryshuar me VKM Nr. 256, datë 29.04.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr 584, datë 08.10.2021, të Këshillit të Ministrave”, “Për shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike” ka shpallur gjendjen e emergjencës për sektorin e energjisë e cila i ka shtrire efektet edhe gjatë gjithë vitit 2023.

Për këtë arsye, në cilësinë e ushtruesit të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, KESH, si prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në vend, është ngarkuar me detyrimin për shërbim publik në kuptim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Në këtë kuadër, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, me VKM Nr. 757, datë 09.12.2021 “Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 620, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Kushteve për Vendosjen e Detyrimit të Shërbimit ndaj të Liçencuarve në Sektorin e Energjisë Elektrike gjatë gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike dhe për Përballimin dhe Parandalimin e saj”, e ngarkon Kompaninë KESH-sh.a. me detyrimin që për qëllime të furnizimit me të gjitha sasi të nevojshme për nevojat e furnizuesit të shërbimit universal, të marrë me qera asete gjeneruese termike të energjisë, të shkëmbeje/depozitojë apo të kryejë transaksione shitblerjeje të energjisë në tregun e lirë.

Në vijim, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 456, date 29.06.2022, vendosi që shoqëria KESH sh.a. të ketë detyrimin për të furnizuar me energji elektrike shoqërinë OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit si dhe për të menaxhuar tepricat e BRE që kanë detyrimin t’ja shesin energjinë shoqërisë FTL sh.a., për atë sasi energjie pas plotësimit të kërkesës së shoqërisë OSSH sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

Viti 2023, cilësohet si një vit i mirë hidrik, çka ka sjellë që 6-mujori I i vitit 2023 e gjithë kërkesa e shoqërisë FSHU sh.a. të mbulohet nga KESH sh.a., dhe tepricat e energjisë përtej mbulimit të kërkesës

dhe mundësisë për depozitim, u shitën në tregun e lirë, duke shmangur derdhjen e ujit pa prodhim energjie elektrike.

Situata pozitive hidrike, ka sjellë ekspozim të ulët ndaj nevojës për import të energjisë, e cila është aplikuar vetëm gjatë 6-mujorit II, në një sasi prej vetëm 561,427 MWh, ose 2.6 herë më pak se sasia e importuar prej 1,460,962 MWh gjatë vitit 2022.

Shtuar kësaj edhe situatën pozitive të uljes dhe stabilizimit të çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare gjatë 2023, gjë e cila uli ndjeshëm ekspozimin ndaj tregjeve/importit, duke lehtësuar aktivitetin operativ dhe tregtar të Korporatës në funksion të përmbushjes së DSHP, sigurinë në furnizim dhe përballimin e gjendjes së emergjencës.

Referuar obligimit të vendosur me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022 dhe Nr. 449, datë 26.07.2023, për vitin 2023, KESH sh.a. ka furnizuar shoqërinë FSHU sh.a. për klientët universal në sasinë prej 6,700,753 MWh.

Gjatë vitit 2023, në funksion të përmbushjes së DSHP, 71% e kërkesës së klientëve universal u garantua nga prodhimi i brendshëm/rezerva energjitike e kaskadës së Drinit, 19%, marrje energji elektrike nga HEC-et e vegjël e me koncension (për atë sasi energjia elektrike që tepron mbas mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes) dhe vetëm 10% nga importi në tregun e lirë.

Pavarësisht kushteve pozitive hidrike dhe tregjeve të stabilizuara, edhe gjatë 2023, Shoqëria u angazhua maksimalisht, në shfrytëzimin e mekanizmave, në funksion të përmbushjes së DSHP-së, duke shfrytëzuar:

- Blerje të energjisë në avancë. U shfrytëzua, në kushtet e parablerjes së energjisë, rezervë energjitike e akumuluar në rezervuarin e HEC Fierzë;
- U realizua testimi dhe gatishmëria i gjeneruesve termik me fuqi 110 MWh, në zbatim edhe të parashikimeve të VKM Nr. 620/2021, me qëllim garantimin e sigurisë në furnizimin me energjie elektrike nga gjenerimi brenda vendit, për periudhat e thata dhe minimizimin e ekspozimit nga importet me çmime të shtrenjta;
- Intensifikimi i shkëmbimit marrje/dhënie të energjisë, veçanërisht me KEK, duke siguruar rezervë energjetike reciproke në periudhat e nevojshme ndërmjet palëve. Konkretisht gjatë 2023, jo vetëm që u mbyll pozicioni marrje me KEK prej -88,679 MWh (në fund të 2022), por në fund të 2023, KESH është në pozicion dhënie me KEK në sasinë prej +56,474 MWh;
- Masa efektive mbi programimin dhe operim racional/efiçent dhe nën monitorim të kujdesshëm për të maksimalizuar prodhimin, por duke administruar në ekuilibër optimal variablat Prurje-Nivel-Rezervë Energjetike, duke kontribuar maksimalisht në përballimin e situatës së emergjencës;
- Shitje sa më efektive në kushtet e periudhave me prurje të mëdha, bazuar në rregulloren e tregtimit.
- Optimizimi ekonomik afat-shkurtër, sipas sinjaleve të çmimeve të tregut dhe bazuar në rregulloren e tregtimit, për të siguruar të ardhura shtesë.
- Në përballimin e situatës së emergjencës, Qeveria e mbështeti Korporatën edhe në aspektin financiar, për minimizimin e efekteve negative. Në buxhetin e shtetit për 2023, u planifikua Kontigjenca për Mbështetjen e Sektorit Energjistik në vlerë 12 Mld. Lek për KESH. Si rezultat i performancës pozitive të Korporatës ky fond nuk u aktivizua.

## **2.4 PROGRAMI EKONOMIKO-FINANCIAR I KESH SH.A. PËR VITIN 2023**

Gjatë vitit 2023, KESH sh.a. zhvilloi aktivitetin, bazuar në PEF 2023, të miratuar me vendimin e KMB të KESH sh.a. Nr. 19; datë 22.12.2022 “Për miratimin e Programit Ekonomiko-Financiar të Shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2023 dhe parashikimi për 2024-2027”, miratuar përfundimisht me vendimin e APA Nr. 10253/1, datë 04.01.2023. Bazuar mbi performancën operative ekonomiko-financiare gjatë periudhës, si rezultat i situatës pozitive hidrike, por edhe uljes dhe stabilizimit relativ të tregjeve/çmimeve globale të energjisë, PEF 2023 (2024-2027) u rishikua, me vendimin Nr. 9; datë 05.06.2023, të KMB "Mbi miratimin e disa ndryshimeve në Programin Ekonomiko-Financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2023", miratuar përfundimisht me vendimin e APA Nr. 5434/1; datë 30.06.2023.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse të volumeve të energjisë/bilanci energjistik dhe krahasimi ndërmjet Planit të Miratuar 2023 dhe Planit të Rishikuar 2023:

Tabela 1: Bilanci Energjitik Plani i Rishikuar 2023 vs Plani i Miratuar 2023 (MWh)

TREGUESIT - Plani BE 2023 KESH sh.a. (MWh)	BE 2023 (PEF i Miratuar)	BE 2023 (PEF i Rishikuar)	Ndryshimi BE në Vlerë (PEF i Rishikuar vs PEF i Miratuar)	Ndryshimi BE në % (PEF i Rishikuar vs PEF i Miratuar)
Prodhimi neto KESH	5.344.850	5.570.734	225.884	4%
Shkëmbimi KESH / marrje (KEK / NOA)	-	5.828	5.828	100%
Kontrate Depozitim-Shkëmbim VKM 620 - 2021 / marrje	-	-	-	0%
Blerje energjie me çmime tregu (import + tregtarë vendas,VKM 757-21)	876.752	692.961	(183.791)	-21%
Blerje energjie për optimizim (import + tregtarë vendas)	-	-	-	0%
Marrje depozitim nga FTL	527.351	365.293	(162.058)	-31%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	64.626	126.806	62.181	96%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	5.100	2.800	(2.300)	-45%
Disbalanca negative KESH	10.800	12.784	1.984	18%
ASHTA Devijim pozitiv	-	2.141	2.141	100%
<b>Total energji për tregtim nga KESH + shkëmbim</b>	<b>6.829.479</b>	<b>6.779.347</b>	<b>(50.131)</b>	<b>-1%</b>
Shitje OSHEE klientë tariforë/FMF/FTL/Alpex	5.657.136	5.798.956	141.820	3%
Shitje OSHEE humbje	-	-	-	0%
Shitje OST humbje/Alpex	170.300	201.135	30.835	18%
Shitje Alpex	-	-	-	0%
Shitje KOSTT humbje	-	-	-	0%
Kthim borxhi shoqërisë FTL, ne zbatim te VKM 456/2022	250.000	250.000	-	0%
Furnizim për nevojat veçake të HEC-ve + TEC Vlora + Qyrsaq	9.191	6.828	(2.363)	-26%
Shkëmbimi KESH / dhënie	-	133.005	133.005	100%
Kontrate Depozitim-Shkëmbim VKM 620 - 2021 / dhënie	-	-	-	0%
Shitje me çmime tregu (eksport + tregtarë vendas)	655.352	230.940	(424.411)	-65%
Shitje energjie për optimizim(eksport + tregtarë vendas)	-	-	-	0%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	36.000	87.373	51.373	143%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	15.500	36.807	21.307	137%
Disbalanca pozitive KESH	36.000	34.075	(1.925)	-5%
ASHTA Devijim negativ	-	229	229	100%
<b>Total energji e tregtuar nga KESH + shkëmbim</b>	<b>6.829.479</b>	<b>6.779.347</b>	<b>(50.131)</b>	<b>-1%</b>
Disbalanca energjie për tu verifikuar nga Operatori i Tregut (OST)	-	(0)	(0)	0%

Në total volumet e energjisë të Planit të Rishikuar parashikohen lehtësisht më të ulta -50,131 MWh (-1%), krahasuar me Planin e Miratuar. Sipas rubrikave, zërat e rishikuar më të spikatur, konsistojnë në:

- **Rubrika - Energji për tregtim nga KESH + shkëmbim marrje:**
  - Prodhimi i brendshëm neto u rishikua me 5,570,734 MWh, ose +225,884 MWh/+4%;
  - Importi/Blerje u rishikua me 692,961 MWh, ose -183,791 MWh/-21%, duke ulur ekspozimin;
  - Marrje depozitim nga FTL me 365,293 MWh, ose -162,058 MWh/-31%;
  - Blerje shërbime balancuese me OST me 126,806 MWh ose +62,181 MWh/+96%;
- **Rubrika – Energji e tregtuar nga KESH + shkëmbim dhënie:**
  - Shitje OSHEE klientë tarifor/FMF/FTL/ALPEX u rishikua me 5,798,956 MWh, ose +141,820/+3%;
  - Shitje humbje OST/ALPEX u rishikua me 201,135 MWh, ose +30,835/+18%;
  - Shkëmbim KESH dhënie u rishikua me 133,005 MWh, ose +100%, duke planifikuar dhënie energjie, ku një pjesë shkon për mbylljen e balancës të 2022 ndaj KEK me rreth -90,000 MWh;
  - Shitje shërbime ndihmëse balancimi me OST+KOST, u rishikua me 124,180 MWh, ose +72,680 MWh/+141%, duke rritur ndjeshëm shitjet në këtë zë.

Tabela 2: PL/PEF i Miratuar 2023 vs PL/PEF i Rishikuar 2023

(Shumat janë të shprehura në mijë lekë)	PL_PEF 2023 (i Miratuar)	PL_PEF 2023 (i Rishikuar)	Ndryshimi në vlerë (PEF i Rishikuar 2023 vs PEF i Miratuar 2023)	Ndryshimi në % (PEF i Rishikuar 2023 vs PEF i Miratuar 2023)
<b>Operacionet e Vijueshëm</b>				
- Të ardhura nga shitja e energjisë:	50,933,831	38,980,896	(11,952,935)	-23.5%
<i>Shitje energjie elektrike për klientët fundorë të lidhur në nivel tensioni 0.4 KV</i>	11,827,444	11,290,252	(537,192)	-4.5%
<i>Shitje energjie elektrike për klientët në TM 6/10/ 20 KV</i>	10,450,404	3,012,221	(7,438,184)	-71.2%
<i>Shitje energjie elektrike për shoqëritë UK në TM 6/10/20/35 KV</i>	1,044,669	1,047,101	2,433	0.2%
<i>Shitje energjie elektrike për shoqëritë në nivel tensioni 35 KV</i>	1,457,381	1,199,732	(257,650)	-17.7%
<i>Shitje energjie elektrike për mbulimin e humbjeve të OSHEE</i>	-	-	-	0.0%
<i>Shitje energjie elektrike për humbjet e Transmetimit OST</i>	1,463,744	669,112	(794,632)	-54.3%
<i>Shitje energjie elektrike për humbjet e Transmetimit KOSTT</i>	-	-	-	0.0%
<i>Shitje energjie elektrike për eksport / Optimizim Energjie</i>	19,867,774	2,780,137	(17,087,637)	-86.0%
<i>Shitje energjie elektrike - OST Disbalanca pozitive</i>	113,666	71,923	(41,743)	-36.7%
<i>Të Ardhura të tjera nga faturim shtesë FSHU</i>	-	949,761	949,761	100.0%
<i>Shitje në ALPEX për humbjet OST</i>	-	2,184,046	2,184,046	100.0%
<i>Shitje në ALPEX për FSHU / FMF</i>	-	10,806,943	10,806,943	100.0%
<i>Të Ardhura të tjera energjie elektrike (rezerva ne rritje OST)</i>	3,262,216	3,610,383	348,168	10.7%
<i>Të Ardhura të tjera energjie elektrike (rezerva ne rritje KOSTT)</i>	1,442,324	1,355,194	(87,129)	-6.0%
<i>Te Ardhura te tjera (-Ashtac Noa)</i>	4,210	4,090	(120)	-2.8%
- Të ardhura të tjera operacionale	-	-	-	0.0%
<b>Shuma e të Ardhurave Operative</b>	<b>50,933,831</b>	<b>38,980,896</b>	<b>(11,952,935)</b>	<b>-23.5%</b>
- Materiale të para dhe të konsumueshme	203,310	203,310	(0)	0.0%
- Blerje Energjie:	35,586,906	21,055,705	(14,531,201)	-40.8%
<i>Blerje Energjie Elektrike me çmime tregu (import dhe tregu vendas)</i>	32,510,064	15,007,860	(17,502,204)	-53.8%
<i>Blerje Energjie Elektrike për optimizim (import dhe tregu vendas)</i>	-	-	-	0.0%
<i>Kompesimi financiar për FTL për energjinë e pakthyer nga depozitimi</i>	2,357,484	1,152,927	(1,204,557)	-51.1%
<i>Kompesim financiar për OST (çmimi i bursës - çmimin e rregulluar)</i>	-	908,419	908,419	100.0%
<i>Kompesim financiar për FSHU (çmimi i bursës - çmimin e rregulluar)</i>	-	3,567,809	3,567,809	100.0%
<i>Tarifë Transmetimi</i>	9,191	6,916	(2,275)	-24.8%
<i>Blerje Energjie për mbulimin e Disbalancave</i>	569,344	221,179	(348,165)	-61.2%
<i>Blerje Shërbime ndihmëse OST</i>	120,920	185,247	64,328	53.2%
<i>Blerje Shërbime ndihmëse KOSTT</i>	19,903	5,347	(14,556)	-73.1%
<i>Shpenzime te tjera energjie elektrike</i>	-	-	-	0.0%
<b>Shpenzime personeli</b>	<b>1,432,871</b>	<b>1,432,871</b>	<b>0</b>	<b>0.0%</b>
<b>Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	<b>4,235,830</b>	<b>4,235,830</b>	<b>0</b>	<b>0.0%</b>
<b>Shpenzime të tjera operacionale</b>	<b>1,174,219</b>	<b>1,383,660</b>	<b>209,440</b>	<b>17.8%</b>
<b>Shpenzime asetë gjenerues termik</b>	<b>14,386,363</b>	<b>8,882,326</b>	<b>(5,504,037)</b>	<b>-38.3%</b>
<b>Shuma e Shpenzimeve Operative</b>	<b>57,019,499</b>	<b>37,193,701</b>	<b>(19,825,798)</b>	<b>-34.8%</b>
<b>EBIT</b>	<b>(6,085,668)</b>	<b>1,787,195</b>	<b>7,872,863</b>	<b>129.4%</b>
Të ardhura financiare	130,398	130,398	0	0.0%
Shpenzime financiare	(687,065)	(687,065)	0	0.0%
<b>Të Ardhura/Shpenzime Financiare Neto</b>	<b>(556,667)</b>	<b>(556,668)</b>	<b>0</b>	<b>0.0%</b>
<b>Rezultati para Tatimit</b>	<b>(6,642,336)</b>	<b>1,230,527</b>	<b>7,872,863</b>	<b>118.5%</b>
Kreditim i tatimit mbi fitimin	-	184,579	184,579	100.0%
<b>Rezultati Neto i Periudhës nga Operacionet e Vijueshëm</b>	<b>(6,642,336)</b>	<b>1,045,948</b>	<b>7,688,284</b>	<b>115.7%</b>

Rishikimi i Bilancit Energjistik, solli edhe rishikimin e Programit të operacioneve të vijueshëm (tabela 2), ku ndryshimet kryesore janë:

- Me hyrjen në aktivitet të Bursës së Energjisë ALPEX, shitjet e kuotueshme me çmime të tregut riklasifikohen/rishpërndahen drejt këtij institucioni të tregut të organizuar. Njëkohësisht, bazuar edhe në realizimin 3-mujor të volumeve të energjisë, por veçanërisht uljes dhe stabilizimit të çmimeve të energjisë, rishkohen në mënyrë më realiste të ardhurat nga shitja në tregun e lirë. Si rezultat i këtyre faktorëve, të ardhurat totale nga aktiviteti energjistik rishikohen të jenë në 38.98 Mld. Lek, ose -11.95 Mld. Lek/-23.5% më pak se plani fillestar i miratuar prej 50.93 Mld. Lek.
- Si rezultat i volumeve pozitive, shpenzimet janë ulur ndjeshëm parashikimet për blerje të energjisë në tregun e lirë me -54%, duke ulur shpenzimet totale të aktivitetit energjistik në vlerën 21.05 Mld. Lek, ose -14.53 Mld. Lek/-40.8% më pak, se plani fillestar i miratuar prej 35.59 Mld. Lek.

Edhe shpenzimet e tjera të përgjithshme të aktivitetit, si rezultat i qasjes së menaxhimit eficient të kostove u rishikuan më të reduktuara, veçanërisht ato të lidhura me gjeneruesit termik.

Në total shpenzimet e operacioneve të vijueshëm rishikohen në vlerën 37.19 Mld. Lek, ose -19.82 Mld. Lek/-34.8% më të ulta se plani fillestar i miratuar prej 57.02 Mld. Lek.

- Nga netimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, aktiviteti i operacioneve të vijueshëm rishikohet me rezultat pozitiv para tatimit (EBT) prej 1.23 Mld. Lek, ose +7.87 Mld. Lek/+118.5% më shumë, duke transformuar rezultatin EBT negativ, parashikuar në planin fillestar me -6.64 Mld. Lek.

## 2.4 PËRMBLEDHJE E SITUATËS HIDRIKE

Referuar portofolit aktual të gjenerimit pothuajse 100% hidro, situata hidro-meteorologjike në aktivitetin operacional të prodhimit, merr rëndësinë kryesore në performancën e prodhimit të brendshëm. Aq më tepër kjo në kushtet e emergjencës së furnizimit me energji elektrike, ku menaxhimi sa më eficient i prodhimit dhe rezervës energjetike është thelbësor për të gjeneruar maksimalisht prodhim të brendshëm, që do të thotë, ulje të ekspozimit ndaj tregjeve me çmime të larta.

Në kuptimin hidrik viti 2023, startoi pozitivisht, ku është për tu përmendur hyrja me kuotë të lartë e nivelit në liqenin e Fierzës. Kështu më datë 1 Janar 2023 liqeni rezulton në kuotën 291.67 mmnd, ose +16.54 m më e lartë krahasuar me treguesin respektiv të 2022 me prej 275.13 mmnd.

Po kështu ky nivel i fillimvitit 2023 prej 291.67 mmnd, rezulton +15.43 m më i lartë, krahasuar me të njëjtin tregues shumëvjeçar prej 276.24 mmnd. Kjo hyrje pozitive e 2023, erdhi si rrjedhojë e eventeve të reshjeve të muajve Nëntor dhe Dhjetor të fundvitit 2022.


Nga pikëpamja hidrike viti 2023 ka qenë një vit pozitiv, me reshje dhe prurje që kanë variuar mbi vlerat mesatare shumëvjeçare përkatëse. Ecuria e prurjeve natyrore ka qenë lineare dhe e qendrueshme, pa evente të mëdha dhe të papritura hidrike. Kjo ka bërë të mundur dhe ka ndihmuar menaxhimin sa më eficient të rezervës energjetike dhe mirëplanifikimin e prodhimit të energjisë elektrike.

Shkurtimisht treguesit kryesorë të operim/shfrytëzimit të kaskadës së Drinit, jepen si në vijim:


- **Prurjet** mesatare të 2023 janë 196.5 m<sup>3</sup>/s, ose +14.2% më të larta, krahasuar 2022, prej 172 m<sup>3</sup>/s. Krahasuar edhe me mesataren shumëvjeçare (1993-2022) prej 178.9 m<sup>3</sup>/s, rezulton +9.8 % më lart.
- **Niveli** mesatar i shfrytëzimit për 2023, rezultoi 285.9 mmnd, ose +9.65 m më i lartë, krahasuar me të njëjtin tregues të 2022, prej 276.25 mmnd. Ndërsa, në krahasim me periudhën shumëvjeçare (1993-2022) prej 280 mmnd, rezulton +5.9 m më lart.
- **Rezerva Energjetike** në fillim të vitit 2023 ishte 1,193 GWh ndërsa në fund të 2023 u mbyll me 913 GWh. Rezerva mesatare energjetike mujore (fillim muaji) gjatë 2023 ishte 1,035 GWh, mjaft më lart prej +56.4%, krahasuar me të njëjtin tregues të 2022 prej 661 GWh.
- **Prodhimi Bruto** në kaskadën e Drinit per vitin 2023, rezultoi 5,167 GWh ose +880 GWh (+21.5%), krahasuar me mesataren shumëvjeçare (1993-2022) prej 4,253 GWh.

Diferenca është edhe më e ndjeshme, krahasuar me prodhimin e vitit 2022 (3,892 GWh), ku gjatë vitit 2023 janë gjeneruar +1,275 GWh (+32.8%) më tepër energji elektrike, duke rritur ndjeshëm performancën e shfrytëzimit.

**Grafiku 3. Rezerva Energjitike - 2023 vs 2022 (fillim muaji në GWh)**



**Grafiku 4. Prodhimi Bruto i Kaskadës 2023 vs 2022 (GWh)**



Edhe grafikisht, konstatohet qartë që në tërësi viti 2023 rezultoi dukshëm më pozitiv se 2022, duke sjellë edhe prodhim krahasimisht ndjeshëm më të lartë. Pavarësisht situatës së favorshme hidrike dhe aktivitetit të shtuar shfrytëzues, nga grafiku i rezervës energjitike vërehet që Korporata ka ndjekur në ekuilibër një administrim rigoroz dhe eficient të kaskadës, e orientuar edhe në drejtim të ruajtjes së rezervës energjitike, në kushtet e emergjencës në sektor.

## 2.5 TË DHËNAT KRYESORE OPERATIVE TË AKTIVITETIT TREGTAR DHE EKONOMIK


Gjatë vitit 2023, Korporata e zhvilloi aktivitetin në kushtet e situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, duke arritur të realizojë aktivitetin e saj operacional që konsiston në:

- Sigurimin e volumeve të energjisë elektrike për furnizim të detyrimit për shërbimin publik;
- Ofrimin në kohë dhe me cilësinë e duhur të shërbimeve të balancimit dhe atyre ndihmëse;
- Aktivitet tregtar sa më dinamik, për të siguruar dhe maksimizuar të ardhura nga veprimtaria komerciale në tregun e lirë, favorizuar nga në një vit i mirë hidrik, dhe situata më pozitive e tregjeve globale gjatë vitit 2023;

Vlerësimi i përmbledhur i treguesve kryesor të performancës operationale të 2023, pasqyrohen të krahasuar me periudhën respektive të 2022.

- Grafiku i mëposhtëm pasqyron volumet kryesore të aktivitetit të energjisë disponibël për tregtim dhe shkëmbimit/marrje për 2023, krahasuar me 2022:

**Grafiku 5. Energji për tregtim + marrje - Realizim 2023 vs 2022 (MWh)**




Referuar grafikut më lart, vërehet qartësisht struktura mjaft e ndryshme e flukseve hyrëse të volumeve të energjisë për 2023, kundrejt 2022, veçanërisht në:

- Prodhimi Neto i KESH për 2023, rezulton me + 1,271,751 MWh/+33% më lart, krahasuar me 2022. Pra situata pozitive hidrike, ka bërë të mundur që prodhimi i brendshëm gjatë 2023 të kap 73% të totalit të volumeve hyrëse, kundrejt 61% të 2022;
- Blerja e energjisë nga tregu/importi, rezulton me -904,152 MWh/-62% më ulët, krahasuar me 2022. Pra, ekspozimi ndaj tregut/importit është ulur me 2.6x;
- Në total, flukset hyrëse të energjisë për 2023, janë 7,036,222 MWh ose +683,559 MWh/+11% më shumë, krahasuar me 2022 prej 6,352,663 MWh.

- Në krahun tjetër të bilancit energjistik, pasqyrohen treguesit kryesor flukseve dalëse të energjisë. Grafiku i mëposhtëm pasqyron volumet kryesore të energjisë së tregtuar dhe shkëmbimit/dhënie në për 2023, krahasuar me 2022:


Grafiku 6: Shitje energjie + dhënie - Realizim 2023 vs 2022 (MWh)



Referuar grafikut më lart, vërehet qartësisht dinamika e flukseve dalëse të volumeve të energjisë për 2023, kundrejt 2022, veçanërisht në:

- Shitje humbje transmetimi në 2023, janë rritur me +125,666 MWh, ose me 2.4x krahasuar me 2022;
- Shitje tregu i lirë+optimizim në 2023, janë rritur me +444,340 MWh, ose me 3.2x se 2022;
- Shërbime ndihmëse/balancimi në 2023, janë rritur me +16,032 MWh, ose +14%, se 2022;
- Nëse në 2022, DSHP përbënte 90% të totalit të shitjeve, në 2023 DSHP përbënte 81% të totalit të shitjeve. Shtuar kësaj edhe +11% më shumë volume totale shitje në 2023 krahasuar me 2022, rezulton që KESH në 2023, ka shitur energji në tregun e lirë 1,287,064 MWh ose 2x më shumë se 2022, prej 661,974 MWh. Kjo ka bërë diferencën pozitive në tregtim të 2023, kundrejt 2022.
- Realizimi i treguesve kryesor agregat të 2023, sipas pasqyrës të aktivitetit të operacioneve të vijueshëm të krahasuar me 2022, pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 7. Të ardhura/Shpenzime - Realizim 2023 vs 2022 (Mld. Lek)



Referuar grafikut më lart, shkurtimisht evidentohet:

- Të ardhurat nga totale nga aktiviteti 2023 janë rritur me +5.93 Mld. Lek ose 15% krahasuar me 2022;
- Shpenzimet nga aktiviteti energjitik për 2023, janë ulur ndjeshëm me -40.7 Mld. Lek, ose -3.4x, krahasuar me 2022, si rezultat i uljes së ndjeshme të importit dhe çmimeve më të ulta në tregje;
- Shpenzimet e Përgjithshme të Aktivitetit + Financiare Neto, janë + 0.75 Mld. Lek ose +10%, krahasuar me 2022, kryesisht ato financiare/interesa;
- Si rezultat i situatës pozitive hidrike, importit të ulët dhe stabilizimit të çmimeve të energjisë në tregje, Rezultati para tatimit (EBT) i aktivitetit për 2023 rezulton 20.06 Mld. Lek, mjaft pozitiv dhe në kontrast të ndjeshëm me vitin 2022, ku rezultati EBT rezultoi negativ me -25.82 Mld. Lek. Padyshim që aktiviteti i 2023, pothuajse ka rikuperuar vitin e vështirë 2022, duke shënuar arritje të rëndësishme.

## 2.6 KOMERCIALIZIMI I MËTEJSHËM I AKTIVITETIT

Tregu i energjisë po ndryshon me ritme të shpejta në krahasim me disa vite më parë. Në mbarë globin, qeveritë po vënë në zbatim politikat kundër emetimit të karbonit dhe gjatë 5 viteve të ardhshme, shumë shtete do të kenë implementuar disa politika për reduktimin e nivelit të karbonit.

Në Shqipëri po investohet kryesisht në ndërtimin e parqeve fotovoltaike si edhe është në hapat e para orientimi investues drejt prodhimit të energjisë nëpërmjet parqeve eolike. Strategjia e diversifikimit është plotësisht në përputhje me planet për zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri dhe bashkimin e tregut me Kosovën. Në rrafshin afatgjatë, pas bashkimit të tregut, pritet që burimet tona të qëndrueshme të energjisë, të jenë në gjendje të jenë konkurruese në rajonin e Evropës Juglindore.

Me rritjen e kapaciteteve prodhuese, KESH-sh.a. do të diversifikojë portofolin e prodhimit të energjisë, i cili, deri më sot, pothuaj 100% i varuar nga burime hidrike, ndërsa në vitet e ardhshme, do të jetë një kombinim i burimeve hidrike, fotovoltaike dhe eolike.

Shtimi i diversifikuar i kapaciteteve të reja gjeneruese, duhet të ecë paralelisht me procesin e liberalizimit të tregut. Pas çeljes zyrtare më 11 Prill 2023 dhe funksionimit të Bursës ALPEX, tregu i energjisë elektrike në Shqipëri, përgatitet për hapa të tjerë transformues si:

- Nga 1 Shkurt 2024, tregjet e energjisë të Shqipërisë dhe Kosovës bashkohen në ALPEX.
- Gjithashtu aktiviteti i ALPEX do të njohë nivel dhe dinamikë tjetër, pasi Bursa së shpejti do të implementojë edhe opsionin/procedurën intraday për tregtim të energjisë elektrike.

Vlen për tu theksuar se nga 1 Janar 2024, Shqipëria nuk është më në kushtet e emergjencës për furnizim të energjisë elektrike, çka i krijon mundësi Korporatës të diversifikojë më tej portofolin e tregtimit të energjisë elektrike si në tregun me shumicë, ashtu edhe atë me pakicë. Për më tepër prej datës 1 Janar 2024, konsumatorët e lidhur në nivel tensioni 20 kV dalin në treg të lirë, duke dhënë efekt të dyfishtë pozitiv në aktivitetin komercial të Korporatës, si:

- Lehtëson KESH nga një pjesë e DSHP (detyrim për furnizim) e cila vlerësohet në volum prej 700 GWh. Në këto kushte, KESH do të ketë potencialisht në dispozicion, më shumë sasi të lirë për tregtim, duke u fokusuar në kapjen e sinjaleve të tregut për çmime atraktive, me synim tregtimin e energjisë elektrike në Bursën ALPEX dhe jo vetëm, me objektiv maksimizimin e të ardhurave të Shoqërisë.
- Gjithashtu, liberalizimi i tregut për fashën e tensionit 20 kV, është me interes të lartë për diversifikimin dhe komercializimin e mëtejshëm të portofolit të tregtimit të energjisë edhe në tregun me pakicë ndaj kësaj kategorie konsumatorësh, duke shfrytëzuar licencën e KESH për furnizimin me pakicë.

Në funksion të objektivit të Korporatës për shtrirjen edhe me shume të aktivitetit tregtar në furnizim në tregun me pakicë, është e nevojshme automatizimi i mëtejshëm i proceseve i ndjekjes/monitorimit dhe përditësimit të kërkesës së konsumatorit.

Për këtë qëllim, Korporata është në proces të implementimit të një platforme, konkretisht PLEXOS, e cila do të ndihmoj/automatizoj skenarët e operimit dhe tregtimit për optimizimin e burimeve prodhuese me qëllim maksimizimin e të ardhurave nëpërmjet aktivitetit komercial të energjisë elektrike, si në tregun me shumicë ashtu dhe atë me pakicë.

### 3. ZHVILLIME LIGJORE/RREGULLATORE TË LIDHURA ME AKTIVITETIN 2023

Zhvillimet kryesore ligjore dhe rregullatorë gjatë vitit 2023, të lidhura dhe me impakt në aktivitetin e Korporatës, u përqendruan më së shumti në kuadër të përballimit të gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike me objektiv primar përmbushjen e detyrimit për shërbim publik, për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve universal. Pra, në vazhdim të vitit 2022, edhe gjatë vitit 2023, aktiviteti i Korporatës u fokusua kryesisht në tregun e rregulluar.

#### 3.1 ZHVILLIME LIGJORE

Situata e favorshme hidrike dhe prodhimi pozitiv i vitit 2023 i mundësoi KESH të përballojë ndjeshëm më lehtë se në 2022, detyrimet e veta në përballimin e situatës së emergjencës, të miratuar me:

- Vendimin nr. 584, datë 08.10.2021, të Këshillit të Ministrave dhe e shtyrë po nga Këshilli i Ministrave deri në datën 30 Qershor 2023 dhe më pas deri në datën 31 Dhjetor 2023, përkatësisht me Vendimin nr. 650, datë 10.10.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.584, datë 08.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, i ndryshuar si edhe Vendimin nr. 449, datë 26.07.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr.584, datë 08.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar.

Edhe gjatë vitit 2023, veprimtaria e KESH sh.a. vijoi të bazohet në përcaktimet e miratuara me Vendimin nr. 456, datë 29.06.2022, të Këshillit të Ministrave, me të cilin ky organ miratoi kushtet e reja për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike. Për rrjedhim u shfuqizuan Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe nr. 620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimin e saj”, të ndryshuar.

Sipas këtij Vendimi të Këshillit të Ministrave, KESH sh.a, si shoqëria publike e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen nga shteti:

- Furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit, sipas nenit 109, të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshimet përkatëse, me të gjithë sasinë e nevojshme për furnizimin e klientëve universalë sipas çmimit për njësi të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë dhe kontratës përkatëse, të miratuar nga Bordi i ERE, ku përcaktohet edhe sasia e energjisë elektrike, e nevojshme për furnizimin e të gjithë klientëve universalë.
- Për qëllim të furnizimit me të gjithë sasinë e nevojshme për nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal, KESH sh.a përveç shfrytëzimit të aseteve gjeneruese në administrim apo pronësi për prodhimin e energjisë elektrike ka të drejtë:
  - të kontraktojë asete gjeneruese të energjisë elektrike,
  - të shkëmbejë/depozitojë energji,
  - të kryejë transaksione shit- blerje energjie në tregun e lirë apo të lidhë kontrata afatgjata të shit- blerjes së saj, sipas rregullave përkatëse të miratuara nga Asambleja e shoqërisë.
- KESH sh.a. ka të drejtë që t'i shesë Furnizuesit të Mundësisë së Fundit energji elektrike për furnizimin e kategorive të caktuara të klientëve të dalë në treg të lirë sipas çmimit dhe sasisë së përcaktuar nga Asambleja e shoqërisë KESH.
- KESH sh.a., sasinë e tepërt mujore që i mbetet pas përmbushjes së kërkesës së klientëve universalë dhe pas ezaurimit të sasisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë, mund t'ja shesë

Furnizuesit publik të Tregut të Lirë/FTL për llogari të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, me çmimin e blerjes së energjisë së prodhuesve me përparësi. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet ndërsa ky transaksion kryhet në bazë të një kontrate që negociohet lirisht nga palët dhe miratohet nga Bordi i ERE.

- KESH sh.a ka të drejtë të lidhë kontrata blerjeje të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme që shërbejnë për diversifikimin e prodhimit të tij.
- KESH sh.a ka të drejtë të depozitojë tepricat e krijuara nga prodhimi i burimeve të energjisë për t'u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë apo për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes ndërsa tepricat e mbetura pas plotësimit të këtyre detyrimeve, KESH-i mund t'i shesë në tregun e lirë.
- Gjatë periudhës së emergjencës, KESH sh.a do të furnizojë OST sh.a. me të gjithë sasinë e nevojshme për mbulimin e humbjeve me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi, sipas një kontrate të negociuar nga palët dhe të miratuar nga Bordi i ERE-s.

Sipas vendimit në fjalë, çdo investim i bërë nga KESH sh.a për kapacitete të reja gjeneruese, në funksion të plotësimit të kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit, do të trajtohet si një detyrim i shërbimit publik në lidhje me sigurinë e furnizimit dhe çdo detyrim i vendosur ndaj të licencuarve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në lidhje me burimet e rinovueshme të energjisë, do të konsiderohet detyrim i shërbimit publik.

- Në lidhje me mbështetjen për përballimin egjendjes së emergjencës në sektor, në ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2023", u planifikua Kontigjenca për Mbështetjen e Sektorit Energjistik në vlerë 12 Mld. Lek për KESH, i cili do të akordohej/aktivizohej me VKM deri më 30.06.2024. Si rezultat i performancës pozitive të Korporatës ky fond nuk u aktivizua.

### **3.2 ZHVILLIME RREGULLATORE**

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), gjatë vitit 2023, miratoi disa vendime në lidhje me efekt mbi veprimtarinë e Korporatës, të përmbledhura si më poshtë:

- *Vendim nr.27, datë 16.02.2023 i bordit të ERE "Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023".*

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 327, datë 14.12.2022, vendosi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 8.5652 lekë/kWh për vitin 2023.

Miratimi i këtij çmimi, pavarësisht se bëhet për rregullimin e marrëdhënieve kontraktore dhe financiare me këtë kategori prodhuesish të energjisë elektrike ka ndikim në veprimtarinë ekonomike- financiare të KESH-it, pasi çmimi i shit-blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi është çmimi me të cilin KESH sh.a i shet energjinë elektrike të tepërt, pas plotësimit të kërkesës së klientëve universalë FTL për llogari të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, bazuar në VKM nr. 456, datë 29.06.2022.

Gjithashtu, po bazuar në vendimin e lartpërmendur të Këshillit të Ministrave, me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi gjatë periudhës së emergjencës, KESH sh.a do të furnizojë OST sh.a. me të gjithë sasinë e nevojshme për mbulimin e humbjeve.

- *Vendim nr. 30, datë 16.02.2023 i bordit të ERE "Mbi miratimin e amendimit nr. 1 të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a."*

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 230, datë 12.09.2022, miratoi kontratën e shit-blerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin

e transmetimit për periudhën 02.07.2022 deri më 31.12.2022. Kontrata e miratuar nga ERE i ka shtrirë efektet juridike nga 02.07.2022 deri më 31.12.2022.

KESH sh.a. dhe OST sh.a. kanë shprehur vullnetin e tyre për amendimin e kontratës duke e nënshkruar bashkërisht atë, për ndryshimin e kohëzgjatjes së kontratës, dhe shtrirjen e efekteve të saj deri më datë 30.06.2023, duke përcjellë kontratën në ERE me shkresë të përbashkët ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., me nr. 420 prot. të ERE, datë 20.01.2023 “Për amendimin e kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit”, të miratuar dhe nënshkruar ndërmjet palëve OST sh.a dhe KESH sh.a.

Ndryshimi i kohëzgjatjes së kontratës, erdhi si pasojë e zgjatjes së periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri më datën 30.06.2023, sikurse shprehur në VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike (të ndryshuar)”.

- Vendim nr. 55, datë 24.02.2023 i bordit të ERE “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE lidhur me kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në gjirin e Vlorës”.

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 350, datë 28.12.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë KESH sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm, i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, me fuqi të instaluar 110 MW. Për efekt të plotësimit të dokumentacionit të kërkuar për licencimin e përcaktuar në Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, Bordi vendosi që të zgjasë me një periudhë kohore 30 ditore afatin e vendim-marrjes lidhur me këtë licencim.

- Vendim nr. 75, datë 15.03.2023 i bordit të ERE “Mbi fillimin e procedurës për pajisje me certifikatë të garancisë së origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, të shoqërisë KESH sh.a.”

Me kërkesën me nr. 991, datë 03.03.2023, në bazë të rregullores “Për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i ERE-s, KESH sh.a. paraqiti kërkesën për pajisjen me Certifikatën e Garancisë së Origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, për periudhën 13.05.2022-31.12.2022.

Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 21.07.2022, është vendosur kualifikimi i këtij impianti fotovoltaik ndërsa me këtë vendim, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën përkatëse.

- Vendim nr. 109, datë 27.03.2023 i bordit të ERE “Mbi licencimin e shoqërisë KESH sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i lundrues i instaluar në portin e Triportit në gjirin e Vlorës”.

Me anë të këtij vendimi dhe në vijim të Vendimit nr. 350, datë 28.12.2022, të Bordit të ERE-s, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë KESH sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në gjirin e Vlorës, me fuqi të instaluar 110 MW”, vendosi të licencojë shoqërinë KESH sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga TEC-i lundrues i instaluar në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës, për një afat 2-vjeçar, duke filluar nga data e komisionimit të veprës, të përbërë nga dy gjenerues “Tigri 1”, me kapacitet 50 MW dhe “Tigri 3”, me kapacitet 60 MW.

- Vendim nr.110, datë 27.03.2023 i bordit të ERE “Mbi kërkesën e OST sh.a., për intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues dhe nominimeve të transaksioneve tregtare”.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. në funksion të operimit në tregun shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike ka parashtruar në ERE argumentet, kushtet si dhe vlerësimet mbi implementimin e platformës së menaxhimit të tregut për intervalin kohor 1 orë ku ka vlerësuar se nuk mund të operohet me rezolucion 15 minuta.

Duke qenë se për periudhën në vijim të vitit 2023, ALPEX sh.a. filloi operimin komercial të tregut të energjisë elektrike, Bordi i ERE gjykoji të arsyeshme pranimin e pjesshëm të kërkesës së OST sh.a. që për periudhën 1 Prill 2023 deri 1 Prill 2024, pra për një vit të operohet në tregun e balancimit të energjisë elektrike me intervalin kohor prej 1 ore. Gjatë kësaj periudhe kohore 1 vjeçare do të mund të vlerësohet ecuria e operimit të tregut që do të operohet nga ALPEX sh.a. dhe tregut të balancimit që operohet nga OST sh.a.

- Vendim nr. 135, datë 11.04.2023 i bordit të ERE “Mbi miratimin e amendimit nr. 2 të kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.”.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 30, datë 16.02.2023 miratoi amendimin nr.1 të Kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit” ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230, datë 12.09.2022.

Palët, nëpërmjet kërkesës së përbashkët, kanë përcjellë amendimin nr. 2 të Kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit” ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a, kryesisht duke marrë në konsideratë procesin e operimit të bursës ALPEX, dhe si rezultat kjo Kontratë të trajtohet si Kontratë OTC (Over the Counter Contracts) në DAM që do të zhvillojë ALPEX, ku i jepet përparësi përputhjes së Urdhër Porosive të blerësit dhe shitësit. Si blerësi ashtu edhe shitësi do të krijojnë një portofol të dedikuar për zbatimin e detyrimeve të kontratës OTC në ALPEX DAM për të përmbushur vëllimet sipas kësaj Kontrate duke aplikuar edhe mekanizmin e kompensimit ndërmjet çmimit të klerimit dhe çmimit të kontratës.

- Vendim nr. 164, datë 15.05.2023 i bordit të ERE “Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, të shoqërisë KESH sh.a.”

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 75, datë 15.03.2023, vendosi të fillojë procedurën për pajisjen me Certifikatë të Garancisë së Origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës”, për periudhën 13.05.2022-31.12.2022.

Ndërsa me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi të pajisë me Certifikatë të Garancisë së Origjinës impiantin fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës”, për periudhën 13.05.2022 – 31.12.2022, për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 4,203 MWh.

- Vendim nr. 171, datë 15.05.2023 i bordit të ERE “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2023”.

ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në zbatim të “Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190/2017, të ndryshuar.

Për rrjedhojë, me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE vendosi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2023. Për vitin 2023, vlera e pagesës rregullatore për KESH sh.a. për të 3 (tre) aktivitetet e prodhimit, tregtimit dhe furnizimit, duke përfshirë edhe TEC Vlora, është 36,417,756 Lek.

- Vendim nr. 180, datë 29.05.2023 i bordit të ERE mbi kërkesën e OST sh.a., për miratimin e rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”.

OST sh.a. ka përcjellë në ERE kërkesën për miratim të rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”.

Rregullorja e paraqitur nga OST sh.a., është e përbërë nga rregulla të cilat përcaktojnë elementet e nevojshëm për pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.

- Vendim nr. 262, datë 31.08.2023, i Bordit të ERE “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” (KESH) sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 437, seria f19, të KESH-it në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 29.02.2024.

- Vendimi nr. 271, datë 19.09.2023, i Bordit të ERE “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” (kesh) sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE vendosi që në vijim të procedurës së nisur me Vendimin nr.262/2023, të rinovojë licencën nr. 437, seria f19, të KESH sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, efektive duke filluar nga data 29.02.2024.

- Vendim nr. 280, datë 25.09.2023, i Bordit të ERE “Mbi miratimin e rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE vendosi të miratojë rregullat “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullat për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”, procedura këto të cilat zbatohen nga shoqëria OST sh.a. por afektojnë edhe veprimtarinë e KESH-it në raste të tilla.

- Vendim nr. 296, datë 19.10.2023, i Bordit të ERE “Mbi miratimin e amendimit nr.3, të kontratës ‘Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.’

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e amendimit nr.3 të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet shoqërive OST sh.a. dhe KESH sh.a dhe që konkretisht konsiston në shtyrjen e afatit të kësaj kontrate deri në datën 31 Dhjetor 2023 si rezultat edhe i shtyrjes së afatit të emergjencës në sektorin e energjisë elektrike deri në këtë datë, fundin e vitit 2023.

- Vendim nr. 317, datë 08.11.2023, i Bordit të ERE “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat për dhënien e garancive të origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s pezulloi disa nga përcaktimet dhe kushtet e vendosura në “Rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e Garancive të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019 deri në miratimin nga ERE dhe hyrjen në fuqi të Rregullores për dhënien, transferimin apo anulimin e GO-ve, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 24/2023.

Ky ndryshim erdhi edhe për shkak të kërkesës së KESH-it për lëshimin e garancive të origjinës për HEC-et e kaskadës së Drinit si edhe konsultimit që vetë ERE bëri me Sekretariatit e Vjenës, të Komunitetit të Energjisë, për këtë qëllim.

Ky vendim liberalizon procedurat dhe afatet lidhur me lëshimin e garancive të origjinës.

- Vendim nr. 346, datë 22.11.2023, i Bordit të ERE “Mbi kërkesën e shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a KESH)”Për dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Fierzë”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar për periudhën 01.10.2022 deri më 30.09.2023 nga HEC “Fierzë”, për sasinë 1,779,095 MWh, të prodhuar prej tij. Garancia e origjinës, e dhënë sipas këtij vendimi, është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

- Vendim nr.347, datë 22.11.2023, i Bordit të ERE “Mbi kërkesën e shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a KESH)”Për dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Koman”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar për periudhën 01.10.2022 deri më 30.09.2023 nga HEC “Koman”, për sasinë 2.264,089 MWh të prodhuar prej tij. Garancia e origjinës, e dhënë sipas këtij vendimi, është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

- Vendim nr.348, datë 22.11.2023, i Bordit të ERE “Mbi kërkesën e shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a KESH)” Për dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Vau i Dejës”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE vendosi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar për periudhën 01.10.2022 deri më 30.09.2023 nga HEC “Vau i Dejës”, për sasinë 1,134,560 MWh, të prodhuar prej tij. Garancia e origjinës, e dhënë sipas këtij vendimi, është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

#### 4. AKTIVITETI PRODHUES, MIRËMBAJTËS DHE EFIÇENCA NË SHFRYTËZIM

##### 4.1 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE – OPERIMI

Nga pikëpamja hidrike viti 2023 ka qenë një vit pozitiv, me reshje dhe prurje që kanë variuar mbi vlerat mesatare shumëvjeçare përkatëse. Ecuria e prurjeve natyrore ka qenë lineare dhe e qëndrueshme, pa evente të mëdha dhe të papritura hidrike. Kjo ka bërë të mundur dhe ka ndihmuar menaxhimin sa më eficient të rezervës energjetike dhe prodhim më të planifikuar. Mesatarisht gjatë vitit 2023 prurjet në Fierzë rezultuan 196.5 m<sup>3</sup>/s ose +9.8%, krahasuar me periudhën shumëvjeçare 1993-2022, prej 179 m<sup>3</sup>/s. Për më tepër, prurjet mesatare në 2023, janë +14.2% më të larta, krahasuar me ato të 2022, prej 172 m<sup>3</sup>/s. Për rrjedhim situata hidrologjike e vitit 2023 ka rezultuar me prurje mesatare mbi vlerat shumëvjeçare, dhe paraqitet edhe më pozitive, krahasuar me vitin 2022.

**Tabela 3. Prurjet dhe prodhimi 2023 vs Mesatarja Shumëvjeçare**

Prurjet dhe Prodhimi	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Mesatarja 15 vjeçare
<b>Prurjet në Fierzë (m<sup>3</sup>/sek)</b>	<b>196</b>	<b>172</b>	<b>233</b>	<b>119</b>	<b>121</b>	<b>235</b>	<b>184</b>
<i>Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)</i>	<i>106.5%</i>	<i>93.7%</i>	<i>126.6%</i>	<i>64.7%</i>	<i>65.8%</i>	<i>127.7%</i>	
<b>Prodhimi Bruto i Kaskadës (GWh)</b>	<b>5,167</b>	<b>3,892</b>	<b>5,393</b>	<b>3,121.2</b>	<b>3,010</b>	<b>5,902</b>	<b>4,397</b>
<i>Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)</i>	<i>117.5%</i>	<i>88.5%</i>	<i>122.6%</i>	<i>71.0%</i>	<i>68.4%</i>	<i>134.2%</i>	

*Shënim: Mesatarja 15 vjeçare i referohet periudhës 2008-2022*

Prurjet në Fierzë rezultojnë +6.5% më të larta se mesatarja 15 vjeçare (2008-2022), duke konturuar një vit të mirë hidrik. Rrjedhimisht, situata pozitive hidrike u reflektua në prodhimin bruto total prej 5,167 GWh, ose +17.5% më e lartë se mesatarja 15 vjeçare prej 4,397 GWh.

- Prurjet** në liqenin e Fierzës gjatë 6-mujorit I të vitit 2023 ishin rreth 251 m<sup>3</sup>/s ose +47.6% ndjeshëm më të larta, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitin 2022 prej 170 m<sup>3</sup>/s. Në krahasim me mesataren shumëvjeçare (1993-2022) prej 239 m<sup>3</sup>/s, rezulton +5% më shumë.

Gjatë 6-mujorit II 2023, prurjet në liqenin e Fierzës ishin 142 m<sup>3</sup>/s, kjo krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 ku ishin 174 m<sup>3</sup>/s, ose -18.4% më të ulëta. Kjo për shkak se, fundi i vitit 2022 u karakterizua nga mot me reshje të konsiderueshme shiu dhe evente të herëpashershme me reshje dhe prurje të mëdha. Ndërsa, në krahasim me mesataren shumëvjeçare (1993-2022), prej 119 m<sup>3</sup>/s, prurjet gjatë 6-mujorit II 2023 rezultuan rreth +19.3 % më të larta, për shkak të reshjeve të rëna gjatë muajve Nëntor-Dhjetor.
- Niveli** në liqenin e Fierzës më 1 Janar 2023 rezultoi në kuotën 291.67 mmnd ose rreth +16.54 m më e lartë, krahasuar me vitin 2022, prej 275.13 mmnd, duke mundur një start hidrik premtues për operimin e Kaskadës. Krahasuar me nivelin mesatar shumëvjeçar për datën (1993-2022) prej 276.24 mmnd, niveli i liqenit të Fierzës në fillim të vitit 2023, rezultoi +15.43 m më lart. Edhe niveli në fund të vitit 2023 rezultoi 284.49 mmnd ose +8.25 m më lart, krahasuar me mesataren shumëvjeçare (1993-2022) prej 276.24 mmnd.


Niveli mesatar i shfrytëzimit për 2023, rezultoi 285.9 mmnd, ose +9.65 m më i lartë, krahasuar me të njëjtin tregues të 2022, prej 276.25 mmnd, duke paraqitur në këtë tregues, diferencë konstante dhe të ndjeshme me vitin 2022.

Po kështu, krahasuar edhe me treguesit shumëvjeçarë, viti 2023 paraqitet më pozitiv pasi, niveli i shfrytëzimit mesatar mujor prej 285.9 mmnd, qëndron +5.9 m më lart, krahasuar me të njëjtin tregues shumëvjeçar (1993-2022), prej 280 mmnd.

Treguesit pozitiv dhe të qëndrueshëm të nivelit të shfrytëzimit, reflektojnë nivel të kënaqshëm rezerve energjetike, menaxhim eficient të saj dhe siguri në shfrytëzim.


Më poshtë grafiku, performancës së kombinuar mujore Prurje-Niveli 2023, krahasuar me mesataren shumëvjeçare:

**Grafiku 8. Prurjet në Fierzë dhe Niveli Mesatar i Shfrytëzimit për 2023**



- **Rezerva Energjitike** në fillim të vitit 2023 rezultoi me vlerë mjafat të kënaqshme prej 1,193 GWh, duke siguruar një premisë për ecuri pozitive të 2023 dhe ndjeshëm më lart +569 GWh (+91%), krahasuar me 2022. Në fund të muajit Qershor rezerva e akumuluar për stinën e thatë rezultoi në vlerë rekord prej 1,406 GWh, +365 GWh (+35%), krahasuar me 2022 dhe +288 GWh (+26%), krahasuar me mesataren shumëvjeçare. Në fund të vitit 2023 rezerva energjitike e kaskadës rezultoi 913 GWh, +194 GWh (ose +27%), krahasuar me mesataren shumëvjeçare prej për fundvitin prej 720 GWh.

**Grafiku 9. Performanca e Rezervës Energjitike në 2023**




Gjatë 2023, rezerva energjitike mesatare e kaskadës në fillim muaji rezultoi në vlerë 1,035 GWh, ose +56.6 më e lartë se i njëjti tregues prej 661 GWh i vitit 2022.

Po kështu, rezerva energjitike mesatare e kaskadës në fundmuaji për 2023, rezulton 1,011 GWh, ose +23%, më lart se i njëjti tregues i periudhës shumëvjeçare prej 822 GWh

Si rezultat, treguesit e rezervës së akumuluar energjitike të kaskadës së Drinit për vitin 2023, janë ndjeshëm më pozitiv, krahasuar si me vitin 2022, ashtu dhe me periudhën shumëvjeçare (1993-2022). Të gjithë treguesit e Rezervës Energjitike, tregojnë një menaxhim mjaft të kujdesshëm të kaskadës duke dhënë siguri në operim, veçanërisht në përballimin e kërkesës për energji në stinën e thatë.

- Prodhimi** në kaskadën e Drinit për vitin 2023 në vlerë bruto, rezultoi 5,167 GWh ose +914 GWh (+21.5%), krahasuar me mesataren shumëvjeçare (1993-2022) prej 4,253 GWh. Krahasuar me prodhimin e vitit 2022 prej 3,892 GWh, gjatë vitit 2023 janë gjeneruar +1,275 GWh (+32.8%) më tepër energji elektrike, duke rritur ndjeshëm performancën e shfrytëzimit. Për 6-mujorin I të vitit 2023 janë gjeneruar rreth 2,790 GWh ose +63% më shumë, në krahasim me vitin 2022, prej 1,711 GWh. Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (1993-2022) prej 2,354 GWh, prodhimi në 6-mujorin I 2023, është rritur me +18.5%. Gjatë 6-mujorit II të vitit 2023 prodhimi rezultoi rreth 2,377 GWh ose +9% më shumë, në krahasim me 6-mujorin II të vitit 2022, prej 2,181 GWh. Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (1993-2022) prej 1,898 GWh, prodhimi nga kaskada në 6-mujorin II është rritur me +25.24%. Lidhja ndërmjet Prodhimit dhe Rezervës Energjitike, si treguesit kryesor, ndërmjet operimit dhe administrimit të kaskadës, krahasuar edhe me periudhën shumëvjeçare, jepet në vijim:

Grafiku 10. Prodhimi dhe Rezerva Energjitike gjatë vitit 2023



- Referuar grafikut të mëposhtëm, konsumi i ujit/kWh të prodhuar mbetet në tërësi në nivelet e periudhës 15-vjeçare, dukej mbajtur në nivele optimale produktivitetin, në gjenerim. Kjo falë edhe mirëmbajtjes dhe investimeve rinovuese.

Niveli mesatar i shfrytëzimit në Fierzë ishte 285.9 m, ose 3.23 m më i lartë se mesatarja shumëvjeçare prej 282.67 m, ndërsa në HEC Koman dhe Vau i Dejës ky tregues mbetet thujse i njëjtë me mesataren shumëvjeçare. Më poshtë tabela:

Tabela 4. Efienca në Gjenerim gjatë vitit 2023 krahasuar me mesataren shumëvjeçare

Efienca në Gjenerim		Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Mesatarja 15 vjeçare
HEC Fierza	Konsumi i ujit për Prodhim (m <sup>3</sup> /kWh)	3.74	4.09	3.98	4.09	4.04	3.79	3.87
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	285.9	276.25	283.9	279.4	277.0	285.7	282.67
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	91%	86%	86%	85%	84%	87%	86%
HEC Koman	Konsumi i ujit për Prodhim (m <sup>3</sup> /kWh)	4.19	4.20	4.19	4.19	4.23	4.17	4.17
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	171.77	172.14	172.3	172.4	171.7	172.8	172.38
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	77%	76%	79%	76%	76%	72%	78%
HEC Vau i Dejës	Konsumi i ujit për Prodhim (m <sup>3</sup> /kWh)	8.45	8.48	8.49	8.28	8.45	8.48	8.49
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	73.83	73.70	73.9	73.8	74.0	74.3	74.01
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	87%	86%	77%	78%	85%	83%	97%

HEC Fierzë ka rolin parësor të rregullatorit dhe depozituesit të rezervës energjetike, dhe në një vit të mbarë hidrik, mban nivel shfrytëzimi më të lartë, ndërkohë dy HEC-et e tjerë dhe sidomos Komani si HEC me fuqinë më të madhe të instaluar, kanë rolin parësor të prodhimit të energjisë.

- Tabela e mëposhtme, pasqyron krahasimin e efiençës dhe prodhimit në vite të ngjashme meteorologjike.

Tabela 5. Krahasimi i prodhimit dhe efiençës në vite të ngjashme meteorologjike

Efienca në Gjenerim		2023	2021	2018	2013	2010
HEC Fierza	Konsumi i ujit për Prodhim (m <sup>3</sup> /kWh)	3.74	3.98	3.79	3.73	3.58
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	285.90	283.88	285.75	286.38	290.20
	Energji e Prodhuar (GWh)	1,787	1,803	2,209	2,022	2,664
HEC Koman	Konsumi i ujit për Prodhim (m <sup>3</sup> /kWh)	4.19	4.19	4.17	4.20	4.19
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	171.77	172.33	172.82	172.89	171.93
	Energji e Prodhuar (GWh)	2,250	2,440	2,447	2,470	2,873
HEC Vau i Dejës	Konsumi i ujit për Prodhim (m <sup>3</sup> /kWh)	8.45	8.49	8.48	8.44	8.47
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	73.83	73.90	74.30	74.25	74.06
	Energji e Prodhuar (GWh)	1,130	1,149	1,246	1,312	1,510
Konsumi i ujit për Prodhim (m <sup>3</sup> /kWh) e Ponderuar e Kaskadës		4.965	5.039	4.937	4.994	4.877

Konsumi i ujit në HEC për çdo njësi prodhimi qëndron në parametra optimal dhe brenda normave, krahasuar edhe me vite të përafërta hidro-meteorologjike. Për rrjedhojë, edhe treguesi i ponderuar i konsumit të ujit për kaskadën prej 4.965 m<sup>3</sup>/s, qëndron në nivelet e këtyre viteve.

- Referuar grafikut të mëposhtëm, si rezultat i situatës së favorshme hidrike, prurjet mesatare natyrale në kaskadën e Drinit ishin 318 m<sup>3</sup>/s (+5 m<sup>3</sup>/s më të larta se mesatarja 15 vjeçare) dhe u arrit të prodhohej një sasi prej 5,167 GWh, ose +18% më shumë se periodha 15 vjeçare. Gjatë 2023, u

mbajt rezervë mesatare energjetike prej 1,005 GWh (+12% më e lartë se mesatarja 15 vjeçare e rezervës energjetike). Në tabelë evidentohet ruajtja e nivelit të Fierzës në kuota optimale, ku niveli e tij në çdo periudhë të vitit ka qëndruar mbi mesataren 15 vjeçare.

**Tabela 6. Shfrytëzimi dhe Menaxhimi i Prurjeve Natyrale në Kaskadën e lumit Drin**

Treguesit per vitet	2023	2022	2021	2020	2019	Mesatarja 15 Vjeçare	2023 vs Diferenca/Mesatarj a 15 Vjeçare
Niveli në Fillim Janar (mmnd)	291.67	275.13	272.20	275.59	266.17	279.92	11.75
Niveli në Fillim Korrik (mmnd)	296.33	287.97	291.69	291.66	292.73	291.55	4.78
Niveli në Fillim Dhjetor (mmnd)	280.12	280.74	267.77	268.69	273.17	276.37	3.75
Rezerva Mesatare Energjetike (GWh)	1,005	683	946	777	709	896	112%
Prodhimi (GWh)	5,167	3,892	5,393	3,121	3,010	4,397	117.5%
Prurjet Mesatare Natyrale në Drin (m <sup>3</sup> /sek.)	318	310	384	207	221	313	101.6%
Shkarkimet nga Tunelet Fierze (million m <sup>3</sup> )	36.72	0.00	453.43	0.00	0.00	223.79	16.4%
Shkarkimet nga Tunelet Koman (million m <sup>3</sup> )	356.68	221.63	503.14	85.80	24.30	686.41	52.0%
Shkarkimet nga Porta Vau Dejes (million m <sup>3</sup> )	377.56	361.00	1,754.66	172.62	0.00	914.47	41.3%
Shkarkimet totale (million m <sup>3</sup> )	771.0	582.6	2,711.2	258.4	24.3	1,824.7	42.3%
Kapacitetet Gjeneruese në dispozicion (MW)	1,203	1,151	1,183	1,159	1,227	1,212	99.2%

*Shënim: Mesatarja 15 vjeçare i referohet periudhës 2008-2022*

Po kështu, shkarkimet nga tunelet kanë rezultuar relativisht modeste, sa 42.35% e mesatares 15-vjeçare.

Në përfundim, të gjithë treguesit e mësipërm të shfrytëzimit të kaskadës, tregojnë për një programim operimi racional/efiçent dhe nën monitorim të kujdesshëm për të mbajtur në ekuilibër optimal variablat Prurje-Nivel-Rezervë Energjetike-Prodhim.

- Në lidhje me performancën nga impianti PV Diga e Qyrfaq, prodhimi neto i gjeneruar për vitin 2023 është në total 7,541 MWh. Prodhimi më i lartë është regjistruar në Korrik me 964 MWh, ndërsa prodhimi më i ulët është regjistruar në Dhjetor me prodhim 277 MWh. Për periudhën e operimit 2023, impianti PV Diga Qyrfaq ka pasur një faktor kapaciteti mjaft të kënaqshëm prej gati 16%, krahasuar edhe me vitin 2022, prej gati 14%, duke rezultuar në parametrat optimal, referuar si nivelit për teknologjinë PV të aplikuar, ashtu edhe të rrezatimit të zonës ku operon.

#### 4.2 SIGURIA E VEPRAVE HIDROTEKNIKE

Në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Rregullorja e Përgjithshme e Punës në KESH sh.a., Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”, VKM-së Nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”, KESH sh.a., edhe gjatë viti 2023 ka realizuar në mënyrë sistematike monitorimin e gjendjes teknike dhe sigurisë së 6 (gjashtë) digave të kaskadës së lumit Drin në të tre HEC-et e kësaj kaskade që janë nën administrimin e KESH sh.a.

Bazuar në kërkesat e mësipërme lidhur me sigurinë e veprave hidroteknike, janë realizuar monitorimet dhe matje në objektet përkatëse të digave, sistemeve të shkarkimit, veprave të marrjes së ujit si dhe tek masivët rrëshqitës. Në bazë të rezultateve të matjeve dhe vrojtimit të mësipërme është realizuar përpunimi i të dhënave si dhe analiza, interpretimi dhe raportimi i tyre në mënyrë periodike (çdo muaj), si dhe pasqyruar në Raportin Vjetor të Shfrytëzimit, Monitorimit dhe Sigurisë së Digave.

Për kontrollin dhe monitorimin e digave, informacioni i përpunuar është përfutur nga sistemet e monitorimit të instaluar në kaskadë, sikurse janë:

### **1. Sistemi i Monitorimit Gjeologjik**

Është bërë i mundur upgradi i Sistemeve të Monitorimit gjeologjik në HEC-et e Fierzës, Komanit dhe Vau Dejës.

### **2. Sistemi i Monitorimit Gjeodezik**

Për monitorimin gjeodezik të digave të kaskadës kryhet monitorimi i rrjetit gjeodezik i përbërë nga reperë gjeodezik, monumentet gjeodezike, pika e referimi, pika nivelacioni.

### **3. Sistemi i Monitorimit Hidrologjik**

Matjet kryhen në mënyrë automatike dhe transmetimi i të dhënave kryhet në kohë reale. Sektori që kryen këtë monitorim përgjatë vitit 2023 ka qenë pjesë integrale e DOP por që ka vazhduar të mbajë me informacion edhe DVHT (Departamenti i Veprave Hidro-Teknike).

### **4. Sistemi i Monitorimit Sizmik**

Transmetimi i të dhënave kryhet online nga HEC-et në Drejtorinë e Sigurisë së Digave dhe për eventet në raste tërmetesh njoftimet vijnë në kohë reale në DVHT. Është bërë i mundur upgradi i Sistemeve të Monitorimit sizmik në HEC-et e Fierzës, Komanit dhe Vau Dejës.

### **5. Sistemi i Monitorimit të Filtrimeve**

Rezultatet e monitorimeve hidro-teknike kanë përcaktuar edhe aktivitetet prioritare për mirëmbajtjen dhe/ose rehabilitimin e tyre. Punimet civile për mirëmbajtjen e veprave hidroteknike konsistojnë jo vetëm në punime të zakonshme të mirëmbajtjeve dhe riparimeve, por edhe në investime themelore.

## **4.3 MIRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I AGREGATEVE**

Gjatë vitit 2023, Departamenti i Elektro-Mekanik, është përqëndruar në përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit teknik të mirëmbajtjes elektro-mekanike të agregateve dhe pajisjeve në tre hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin, duke harmonizuar mirëmbajtjen e planifikuar periodike me mirëmbajtjen e bazuar në kushtet e pajisjeve (Condition Based Maintenance) nga sistemet online të monitorimit, mbështetur me investime elektromekanike për upgrade/rinovime të plota teknologjike të sistemeve ekzistuese.

Objektivi kryesor i Mirëmbajtjes gjatë vitit 2023 është mbajtja në gatishmëri e kapaciteteve gjeneruese, nëpërmjet diagnostikimit në kohë shoqëruar me shërbime efektive mirëmbajtjeje të agregateve, investime efektive në pajisjet dhe sistemet elektro-mekanike të rëndësishme të agregateve, duke parandaluar avaritë e defektet apo minimizuar numrin e tyre, si dhe mbajtja në gatishmëri të vazhdueshme e pajisjeve të veprave të shkarkimit të plotave.

Ndër investimet e natyrës mirëmbajtëse/ekzistuese apo rinovuese/investuese, më kryesoret përmendim:

- Përditësimi i versionit të software të sistemit SCALA 250, sistemit operativ dhe hardware për DCS SCADA në HEC Koman;
- Rinovimi i sistemit të mbrojtjes së 2 agregatëve me furnizim instalimin/konfigurimin të dy paneleve të reja, i kompletuar me mbrojtjet dixhitale për gjeneratorin, transformatorin e fuqisë dhe te releve njëveprimëshe për HEC Fierzë;
- Rinovimi i sistemit të mbrojtjes së 3 agregatëve me instalim/konfigurim të releve të reja dixhitale në vend të releve ekzistuese REG, RET dhe releve të funksioneve të releve një veprimëshe dhe upgrade për sistemin e mbrojtjeve për 2 agregatët e tjerë në HEC Vau i Dejës;
- Impianti i ri 0,4 kV i nevojave vetjake të përgjithshme të centralit, me dy hyrje 3200A dhe seksionator me automatikë change-over e mbrojtje termomagnetike, daljet me kontroll manual 400A dhe 800/1000A, pajisur me mbrojtje termomagnetike;
- Realizimi Projekti “Ndërrhyrje për mirëmbajtjen e Sistemeve të CO2 në HEC Fierzë dhe HEC Koman”;


- Rinovime sistemesh VI.FV 2 çelësa 3 polar 245 kV me gaz SF6 ne HEC Fierze, 1 (një) çelës 3 polar 245 kV me gaz SF6 për bllokun e AG2 HEC Vau Dejës, sistem monitorimi të parametrave për 8 celësa në të dy HEC-e, dhe zëvendësim i 4 paneleve ndërmjetëse KKL në HEC Fierzë;
- Rehabilitimi i 5 (pesë) udhëzuesve të rrjetave në veprën e marrjes dhe rehabilitimi i 4 (katër) kompleteve të rrjetave në HEC Vau i Dejës.

Tabela 7. Mirëmbajtja e Hidro-Aggregateve 2018-2023


Treguesit e Mirëmbajtjes	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Mesatarja 10-Vjeçare
<b>Orët e Punës së Agregateve (OP)</b>	64,171	52,035	64,622	40,302	39,324	69,377	52,513
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	122.2%	99.1%	123.1%	76.7%	74.9%	132.1%	
<b>Orët e Agregateve në Avari (OA)</b>	26.5	100	67	38	6	49	83
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	31.9%	120.5%	80.5%	46.0%	7.2%	59.0%	
<b>Koeficienti i Gatishmërisë së Agregatëve (OP/OP+OA, %)</b>	99.96	99.81	99.9	99.91	99.98	99.93	99.84
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	100.12%	99.97%	100.06%	100.07%	100.14%	100.09%	
<b>Rastet e Avari-Defekteve (RAD)</b>	20	36	33	14	6	39	34
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	58.8%	105.9%	97.1%	41.2%	17.6%	114.7%	
<b>Orë Pune ndërmjet Defekteve (OP/RAD)</b>	3,209	1,445	1,958	2,879	6,554	1,779	1,969
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	163.0%	73.4%	99.4%	146.2%	332.9%	90.3%	

Shënim: Mesatarja 10 vjeçare i referohet periudhës 2013-2022

Grafiku 11. Treguesit e Mirëmbajtjes së Sistemeve Hidroenergjetike 2018-2023



Viti 2023, shënon tregues optimal në operimin, gatishmëri dhe mirëmbajtje. Treguesi i Orëve së Punës së Agregatëve për 2023 rezulton në 64,171 orë, +12,136 orë pune (+23.3%) më shumë se 2022 prej 52,035 orë pune. Krahasuar edhe me mesataren 10-vjeçare prej 52,513 orë pune, viti 2023 shënon +11,658 (+22.2%) orë pune më shumë. Gjithsesi, orët e punës së agregateve janë tregues që varen direkt nga treguesit hidrik të vitit. Edhe grafiki shikohet që në vitet pozitiv hidrik si 2018, 2021 dhe 2023 orët e punës së agregateve janë ndjeshëm më të lartë se vitet e thata si 2019 apo 2020.



Në Hidrocentralet e kaskadës së Drinit zbatohen planet e integruara dhe të koordinuara të remonteve kapitale, remonteve të mesme dhe ato profilaktike të njësive prodhuese, të pajisjeve të veprave të shkarkimit si dhe të pajisjeve ndihmëse.

Për 2023 treguesit e mirëmbajtjes vijnë të përmirësohen krahasuar me mesataren e 10 (dhjetë) viteve të fundit. Performanca e mirëmbajtjes është përmirësuar si rrjedhojë e gatishmërisë së lartë të njësive për operim, efikasitetit të kontrolleve të vazhdueshme parandaluese, shërbimeve cilësore të mirëmbajtjes gjatë remonteve profilaktike e të mesme, si dhe investimeve për rinovime teknologjike të tyre e pajisjeve të tjera në tre HEC-et e kaskadës së Drinit.

Ndër treguesit e performancës për vitin 2023, krahasuar me 10 vjeçarin apo 2022 mund të përmendim:

- Orët e ndërprerjeve për shkak të anomalive kalimtare kanë qenë vetëm 27, afërsisht -4x më pak se 2022 dhe -3x më pak se mesatarja 10 vjeçare, duke shfaqur nivel të lartë gatishmërie;
- Numri i avarive/defekteve gjatë 2023 ka qenë 20, ose - 40% më pak se mesatarja 10 vjeçare dhe - 44.4% më pak se viti 2022 prej 36 raste.
- Koefficienti i gatishmërisë së agregateve është në vlerën 99.96%, ndjeshëm më lart, krahasuar me mesataren 10 vjeçare prej 99.84% apo me 2022 prej 99.81%.
- Treguesi i Orëve të punës ndërmjet Avari-Difekteve për 2023 rezultoi 3,209, ose 1.6x më e lartë se mesatarja 10 vjeçare prej 1,958 orë, dhe 2.2x më e lartë se viti 2022 prej 1,445 orë.

Për të gjitha rastet e avarive në njësitë e prodhimit të tre HEC-ve të kaskadës së Drinit, asnjëherë ndalimi i tyre nuk ka rezultuar me kohëzgjatje që imponojnë remonte të parakohshme për riparime kapitale. Është e rëndësishme të theksohet që rritja e gatishmërisë ndikon direkt edhe në shkallën e efikasitetit dhe cilësinë e prodhimit.

#### 4.4 CILËSIA E PRODHIMIT

Hidrocentralet e kaskadës mbi lumin Drin (HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës) kanë në funksion sistemet e rregullimit automatik të frekuencës dhe të tensionit që garantojnë cilësinë e energjisë elektrike të prodhuar, duke përbushur në këtë mënyrë kërkesat e kodit të rrjetit.

KESH sh.a., ka përbushur kërkesat e kodit të rrjetit të transmetimit dhe kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, dhe tashme në të gjitha njësite gjeneruese të secilës njësi prodhimi kemi të instaluar:

1. Sistemet statike dixhitale të rregullimit automatik të tensionit të gjeneratorëve (AVR).
2. Sistemet dixhitale të rregullimit automatik të shpejtësisë së turbinave.

Të gjithë sistemet e sipërpërmendura operohen dhe mirëmbahen nga DM dhe sektorët e mirëmbajtjes në të tre njësite gjeneruese të Korporatës duke siguruar në këtë mënyrë:

- a. cilësi dhe parametra bashkëkohorë për rregullimin e tensionit/fuqisë reaktive në dalje të njësive gjeneruese.
- b. cilësi dhe parametra bashkëkohore për rregullimin primar dhe sekondar të frekuencës/fuqisë aktive në dalje të njësive gjeneruese.
- c. rritje të qëndrueshmërisë statike dhe dinamike të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar si rrjedhojë e amplifikimit të lartë dhe të stabilizimit të lëkundjeve të sistemit nga sistemet e rregullimit automatik të tensionit të gjeneratorëve me AVR dhe PSS.
- d. siguri dhe gatishmëri e lartë në operimin e njësive gjeneruese.
- e. rritje të sigurisë dhe besueshmërisë së prodhimit të energjisë/furnizimit të vendit.
- f. të ardhura më të larta për shoqërinë nga shitjet e energjisë elektrike dhe shërbimeve ndihmëse.

## 5. BILANCI ENERGJETIK DHE AKTIVITETI TREGTAR PËR VITIN 2023

Në panoramën makro, nevoja për energji elektrike në Shqipëri është rritur me një ritëm shumë të lartë krahasuar me disa vite më parë. Aktualisht Shqipërisë i nevojiten mbi 5.7 TWh/vit për furnizimin e klientëve universale, krahasuar me rreth 5 TWh/vit që nevojiteshin më parë.

Edhe gjatë vitit 2023, për shkak të vazhdimit të gjendjes së emergjencës në sektorin elektroenergjetik, fokusi i veprimtarisë prodhuese dhe tregtare të Korporatës u përqendrua në sigurimin e volumeve energjetike në funksion të përmbushjes së DSHP-së për furnizim të klientëve universal, të segmentuar në tregun e rregulluar.

- Liçencat e aktivitetit që zotëron KESH sh.a. në prodhim, tregtim dhe furnizim të energjisë elektrike;
- Në kuadrin ligjor mbi “Kushtet e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike”, sipas VKM bazë Nr.584; dt. 08.10.2021, ndryshuar me VKM Nr. 449; dt. 26.07.2023, dhe detyrimet të përcaktuara në VKM Nr. 456; datë 29.06.2022 dhe “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

### 5.1 ANALIZA E BILANCIT ENERGJETIK

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet bilanci energjetik i volumeve të energjisë për vitin 2023:

Tabela 8. Bilanci Energjetik për vitin 2023 (MWh)


Treguesit	Viti 2023 (PEF i Rishikuar)	Viti 2023 (Fakt)	Viti 2023 (Fakt-PEF) (Sasi)	Viti 2023 (Fakt-PEF) (%)
Sasia kontraktuale sipas shifrës së vendosur nga MIE me Vendim Nr.5434/1, datë 30.06.2023 (PEF KESH sh.a. 2023-2027)	5,798,956	5,749,158	-49,798	-0.86%
Prodhimi neto KESH	5,563,906	5,131,482	-432,425	-7.8%
Shkëmbimi KESH / marrje	5,828	57,252	51,424	882.4%
Kontrate Depozitim-Shkëmbim VKM 620 - 2021 / marrje	0	1,939	1,939	100.0%
Blerje energjie me çmime tregu (import + tregtarë vendas, VKM 757-21)	692,961	561,427	-131,534	-19.0%
Blerje energjie për optimizim (import + tregtarë vendas)	0	0	0	0.0%
Marrje depozitim nga FTL	365,293	1,095,448	730,155	199.9%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	126,806	161,103	34,297	27.0%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	2,800	185	-2,615	-93.4%
Blerje Alpex (nga tregtare te regjistruar ne Burse)	0	2,155	2,155	100.0%
Disbalanca negative KESH	12,784	20,534	7,750	60.6%
ASHTA Devijim pozitiv	2,141	4,697	2,557	119.4%
<b>Total energji për tregtim nga KESH + shkëmbim</b>	<b>6,772,520</b>	<b>7,036,222</b>	<b>263,702</b>	<b>3.9%</b>
Shitje FSHU/OSHEE - klientë tariforë	4,582,656	3,681,449	-901,207	-19.7%
Shitje FMF - klientë tariforë/ Alpex	851,007	972,261	121,254	14.2%
Shitur FSHU nga energjia e prodhuar BRE / FTL	365,293	1,095,448	730,155	199.9%
Shitje OST humbje/Alpex	201,135	216,554	15,419	7.7%
Shitje Alpex (tregtare I regjistruar ne Burse)	0	819	819	100.0%
Shitje KOSTT humbje	0	0	0	0.0%
Kthim borxhi shoqërisë FTL, ne zbatim te VKM 456/2022	250,000	105,089	-144,911	-58.0%
Shkëmbimi KESH / dhënie	133,005	184,965	51,960	39.1%
Kontrate Depozitim-Shkëmbim VKM 620 - 2021 / dhënie	0	0	0	0.0%
Shitje me çmime tregu (eksport + tregtarë vendas)	230,940	639,537	408,597	176.9%
Shitje energjie për optimizim(eksport + tregtarë vendas)	0	6,000	6,000	100.0%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	87,373	82,658	-4,714	-5.4%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	36,807	23,053	-13,754	-37.4%
Disbalanca pozitive KESH	34,075	23,704	-10,371	-30.4%
ASHTA Devijim negativ	229	4,685	4,456	1946.8%
<b>Total energji e tregtuar nga KESH + shkëmbim</b>	<b>6,772,520</b>	<b>7,036,222</b>	<b>263,703</b>	<b>3.9%</b>
Disbalanca energjie për t'u verifikuar nga Operatori i Tregut (OST)	-0	-0	-0	0%

**Energji e Prodhuar + Blerje (Disponibël për Tregtim):**

- Referuar tabelës së treguesve në volume të bilancit energjetik për 2023, rezulton që prodhimi neto ka qenë në sasinë mbi 5,13 TWh me vetëm -7.3% nga plani i rishikuar. Konsiderohet një rezultat shumë i mirë duke e klasifikuar 2023 si vit pozitiv hidrik.
  - Energji e blerë në treg të lirë/import 0.56 TWh, ose -17% nga plani i rishikuar, duke ulur edhe më tej ekspozimin ndaj importit.
  - Marrje depozitim nga FTL për mbullim humbje në shpërndarje prej gati 1.1 TWh, referuar VKM nr. 456; dt. 29.06.2022, nga depozitimet FTL/BRE, si rezultat i një viti pozitiv hidrik.
  - Blerje energjie për optimizim portofoli ku përfshihen edhe blerja e shërbimeve ndihmëse, disbalancat negative (OST/KOSTI) dhe devijimet(+) përllogariten në rreth 189 GWh.
  - Shkëmbimi në marrje i energjisë ka pasur volum prej 57.2 GWh.
- Në total, volumi i energjisë elektrike për tregtim nga KESH sh.a. ka rezultuar në sasinë mbi 7.036 TWh ose +3.9% më shumë se programimi në PEF.

Grafikisht, volumet hyrëse të energjisë elektrike sipas muajve për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

**Grafiku 12. Energjia elektrike disponibël për shitje/tregtim për vitin 2023 (MWh)**




**Energji e Shitur (Tregtuar):**

- Energjia e shitur për klientët e FSHU dhe FMF rezulton në sasinë në 5.75 TWh. Pra objektivi kryesor për sigurimin e energjisë për DSHP në kushtet e emergjencës është arritur.
- Energjia elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit ka qenë në sasinë prej 217 GWh.
- Energjia elektrike e shitur në tregun e lirë (në kushtet e prurjeve) rezulton në sasinë prej gati 640 GWh.
- Kthim Borxhi FTL për mbullim humbje në shpërndarje prej mbi 105 GWh, referuar VKM nr. 456; dt. 29.06.2022.

- Energji e shitur për optimizim portofoli ku përfshihen edhe shitja e shërbimeve ndihmëse, disbalancat pozitive (OST/KOSTT) dhe devijimet(-) përlloragriten mbi 140 GWh ose -11.6% se programimi i rishikuar prej 158.4 GWh.
- Shkëmbimi në dhënie i energjisë me KEK ka pasur volum prej gati 185 GWh. Konkretisht gjatë 2023, u mbyll pozicioni marrje me KEK prej -88,679 MWh (në fund të 2022). Nga shkëmbimi marrje-dhënie gjatë vitit me KEK, rezulton që në fund të 2023, KESH është në pozicion dhënie me KEK në sasinë prej +56,474 MWh, të cilën kjo e fundit do ta kthejë, në rast nevojë të KESH.
- Po kështu, si rezultat i vitit të mirë hidrik, nga volumet e depozituara nga BRE/PPE për llogari të FTL, (pas mbulimit të humbjeve në shpërndarje), i janë shitur FSHU për klientët universal rreth 1.1 TWh.

Grafikisht, volumet dalëse të energjisë elektrike sipas muajve për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

**Grafiku 13. Energjia elektrike e shitur/tregtuar për vitin 2023 (MWh)**



## 5.2 AKTIVITETI NË PLOTËSIMIN E DSHP


Në kushtet e emergjencës së furnizimit me energji elektrike, tregu i energjisë elektrike pësoi rikonfigurim të rëndësishëm me theks tek aktiviteti në tregun e rregulluar. Në këto kushte, prioritet absolut për Korporatën ishte sigurimi dhe furnizimi me energji për plotësimin e detyrimit për shërbim publik për konsumatorët tarifor të ndarë në dy nivele:

- Klientët tariforë të OSHEE/FSHU, që përfaqësojnë nivelin e tensionit 0.4 kV, për shitje me çmim të rregulluar 2.6 Lek/kWh (pa TVSH) dhe ujësjellësa me çmim të rregulluar 5.7 Lek/kWh. Përafërsisht, kjo kategori ka një konsum total prej ±4.7 TWh/vit.
- Klientët tariforë të OSHEE/FMF, që përfaqësojnë nivelin e tensionit 6/10/20 kV, për shitje me çmim të rregulluar prej 12 Lek/kWh (pa TVSH). Përafërsisht kjo kategori ka një konsum prej ±1 TWh/vit.

Pra në total, furnizimi për DSHP për 2023, u parashikua (si në PEF e Miratuar ashtu edhe atë të Rishikuar), sasia vlerën referencë prej ±5.7 TWh/vit.

Për vitin 2023 KESH sh.a ka furnizuar shoqërinë FSHU/FTL për klientët universal në sasinë **5,749,158 MWh**, duke plotësuar volumet e furnizimit për klientët universal, sipas detyrimit të vendosur me Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.06.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.


**Grafiku 14. Furnizimi – Detyrimi i Shërbimit Publik 2018-2023 (GWh)**



Edhe grafikisht, identifikohet përbushja e përgjegjësisë së KESH ndaj DSHP, duke siguruar volumet e nevojshme për klientët e segmentuar në tregun e rregulluar, duke ofruar siguri të plotë në furnizimin e energjisë elektrike.

Në kushtet e gjendjes së emergjencës, e rëndësishme është struktura e burimeve nga ku janë siguruar volumet e energjisë në plotësimin e DSHP, ndaj kërkesës së FSHU & FTL për furnizimin e klientëve universal. Struktura e burimeve nga u sigurua kjo energji paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


**Grafiku 15. Struktura e Sigurimit të Energjisë për DSHP 2023 (GWh)**



Referuar strukturës së sigurimit të furnizimit për DSHP për 2023, krahasuar me 2022, rezulton në vijim:

- Si rezultat i gjenerimit të shtuar, për vitin 2023, duke e krahasuar me vitin 2022 Korporata e ka plotësuar kërkesën e furnizimit për DSHP në masën 71% nga prodhimi i brendshëm, kundrejt 61% që ishte për vitin 2022, duke siguruar një shtesë prodhimi të brendshëm në volume prej 622 GWh ose +10% krahasuar me vitin 2022. Ky rezultat, e lehtësoi mjaft Shoqërinë, në funksion të përbalimit të gjendjes së emergjencës, duke rritur ndjeshëm volumet nga prodhimi i brendshëm, i cila ul ekspozimin nga import i detyruar për plotësim të DSHP;
- Po kështu, si rezultat i vitit pozitiv hidrik, gjatë vitit 2023, kërkesa për plotësim të DSHP-së u përmbush me 19% nga volumet e depozituara nga PPE për llogari të FTL (për atë sasi energji elektrike që tepron mbas mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes), krahasuar me 11% për 2022. Ky mekanizëm siguroi një shtesë volumesh energjie prej 469 GWh, ose +8% krahasuar me vitin 2022, i cili ndihmoi edhe më shumë në plotësim e kërkesës të furnizimit për DSHP. Ndër të tjera mekanizmi i depozitim/shkëmbimit në funksion të mbulimit të humbjeve në shpërndarje, dhe tepricave që mund të rezultojnë përtej saj, është një mekanizëm mjaft i gjetur, pas vendos kushte më të drejta në përgjegjësinë dhe kontributin që duhet të japin të gjithë prodhuesit, jo vetëm gjatë gjendjes së emergjencës por edhe në vazhdimësi në funksion të DSHP-së. Duhet kuptuar që ndaj furnizimit për DSHP, përgjegjësia nuk duhet të mbetet vetëm tek KESH sh.a. si operatori publik, por duhet të kontibujnë të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike, pasi përtej biznesit, kjo është përgjegjësi kombëtare e lidhur me sigurinë në furnizim me energji elektrike ndaj konsumatorëve dhe për atë kohë sa pjesë sensitive të tregut do funksionojnë ende në formë të rregulluar, pra me furnizim për DSHP.
- Burimi i tretë i sigurimit të volumeve të energjisë të furnizimit të DSHP-së, rezulton importi/tregu i lirë. Ekspozimi ndaj këtij opsioni gjatë 2023, rezulton vetëm 561 GWh, që përbën masën 10% ndaj kërkesës totale të furnizimit për DSHP. Krahasuar me vitin 2022 prej rreth 1,461 GWh, ekspozimi i Korporatës ndaj këtij opsioni është ndjeshëm më i ulët, duke blerë -900 GWh më pak, ose -2.6x më pak volume energjie nga importi/tregu i lirë. E rëndësishme është jo vetëm ulja në sasi e blerjes së energjisë/importit, për furnizim të DSHP-së, por ulja në vlerë ekonomike e këtij ekspozimi, ndaj opsionit në fjalë.  
Gjatë vitit 2022, shpenzimi për blerjen në treg të lirë/import i energjisë kapi vlerën 446 Mln. Eur (pa TVSH). Ndërkohë, gjatë vitit 2023, kjo shifër rezultoi në vetëm 62 Mln. Eur, me diferencë të ndjeshme me -384 Mln. Eur, ose -7.2x më pak se 2022. Si rezultat, ulja e ndjeshme e sasisë së blerë treg të lirë gjatë 2023 prej -2.6x më pak se 2022, shoqërohet respektivisht me ulje edhe më të ndjeshme në koston e blerjes me -7.6x, krahasuar me 2022. Kjo, për arsye të efekteve të mëposhtme:
  - Nëse gjatë vitit 2022, si viti më i vështirë i tregjeve të energjisë, çmimi i energjisë së blerë/importuar nga Korporata ishte mesatarisht mbi 305 Eur/MWh, gjatë vitit 2023, ky indeks rezultoi në 110.5 Eur/MWh, ose -2.8x më i ulët krahasuar me 2022. Pra ulja dhe stabilizimi i çmimeve në tregjet globale, ka impakt të ndjeshëm në kosto.
  - Efekti i dytë, jo pak i rëndësishëm është ai i lidhur me kapjen e sinjaleve të tregut mbi çmimet e energjisë. Kështu gjatë 6-mujorit I të 2023, çmimi mesatar base-load i HUPX, figuron në rreth 117 Eur/MWh. Gjatë kësaj periudhe, Korporata nuk ka kryer asnjë blerje në treg të energjisë për plotësimin e DSHP. Ndërkohë që e gjithë sasia e blerë/importuar prej 561 GWh për këtë qëllim, është kryer gjatë 6-mujorit II të 2023, ku çmimi mesatar base-load i HUPX për këtë periudhë figuron më i ulët, në rreth 98 Eur/MWh, duke rezultuar në një menaxhim edhe më eficient në aspektin komercial, i kombinuar ndërmjet operimit të brendshëm dhe importit të energjisë.
- Referuar shitjeve në plotësimin e DSHP, për klientët tariforë të OSHEE/FSHU, që përfaqësojnë nivelin e tensionit 0.4 KV me çmim të rregulluar 2.6 Lek/kWh (pa TVSH), klientët ujësjellësa me çmim të rregulluar 5.7 Lek/kWh dhe klientët tariforë FMF, të tregtuar nëpërmjet FTL dhe Alpex që përfaqësojnë nivelin e tensionit 6/10/20 kV me çmim të rregulluar prej 12 Lek/kWh (pa TVSH), më poshtë pasqyrohen grafikisht pesha e sasive dhe e shitjeve përkatëse në tregun e rregulluar:

Grafiku 16. Shitje klientë FSHU vs Klientë FMF/FTL & Alpex për 2023 (sasi & vlerë)



- Referuar grafikut të mësipërm, pjesa dërrmuese prej 83% e sasisë së energjisë për DSHP lëvrohet tek FSHU për furnizim të klientëve universal të lidhur në nivel tensioni 0.4 kV+ujësjellësa dhe vetëm 17% janë lëvruar për klientët FMF, të lidhur në nivel tensioni 6/10/20 kV, nëpërmjet FTL dhe Alpex.


Në vlera monetare, të ardhurat nga furnizimi FSHU rezultojnë 126.3 Mln. Eur, ose 53% e DSHP. Ndërkohë, të ardhurat nga furnizimi për klientët FMF nëpërmjet FTL & Alpex, rezultojnë 110.5 Mln. Eur, ose 47% e DSHP. Pavarësisht që në sasi, furnizimi FSHU është gati 5x më i lartë se për FMF, në të ardhura, ky raport është i përafërt 53% vs 47%. Kuptohet që rolin kryesor në këtë rezultat e luan diferenca në çmimin e shitjes, ku për FSHU është 2.6 Lek/kWh, ndërsa për FTL 12 Lek/kWh, pra 4.6x më i lartë.

### 5.3 AKTIVITETE TREGTARE TË TJERA

- Si rezultat i situatës së favorshme hidro-meteorologjike gjatë 2023, Korporata kishte volume disponibël për shitje në tregun e lirë, veçanërisht në periudhat me reshje dhe prurje të shtuara. Kjo stimuloi aktivitetet të shtuar komercial duke siguruar të ardhura të konsiderueshme nga tregtimi i energjisë.

Grafiku i mëposhtëm, pasqyron shitjet në volume dhe të ardhurat nga ky aktivitet për periudhën 5 vjeçare 2019-2023:

Grafiku 17. Shitjet e energjisë në kushtet e prurjeve për vitet 2019-2023



Referuar grafikut të mësipërm, shitjet e energjisë në volume në kushtet e prurjeve janë 639,537 MWh, ose 3.3x më shumë, krahasuar me vitin 2022, prej 194,536 MWh.

Në terma ekonomik, të ardhurat nga ky aktivitet rezultuan në gati 56 Mln. Eur, ose 1.7x më shumë se viti 2022, duke arritur rekord për periudhën 5 vjeçare 2019-2023.


Pavarësisht se viti 2021 ka volume të shitura më shumë se 2023, në vlerë të ardhurash viti 2023 siguroi më shumë se 2021, si efekt i çmimeve më të larta të energjisë së shitur.

Po kështu, grafiku i mësipërm, paraqet varësinë e ndjeshme të performancës së shitjeve në tregun e lirë ndaj kushteve hidro-meteorologjike, ku qartësisht dallohen aktivitetet shitjesh i kufizuar në vitet e pafavorshme hidrike 2019, 2020 dhe 2022, krahasuar me vitet e favorshme hidrike 2021 dhe 2023. Për vetë peshën e lartë që këto të ardhura kanë në aktivitetin tregtar, ato janë mjaft përcaktuese në performancën dhe rezultatin ekonomik-operativ të periudhës.

- Në lidhje me Shërbimet e ndihmëse/balancimit për vitin 2023, ato kanë qenë në volume të konsiderueshme, krahasuar me vitin 2022. Duhet theksuar se këto shërbime janë pjesë e portofolit tregtar të optimizimit. Pavarësisht volumeve të shtuara si në blerje dhe në shitje, gjithsesi edhe për vitin 2023 volumet e blerjeve për shërbime balancimi janë përsëri më të larta se ato të shitjeve, duke treguar përsëri rolin vendimtar që ka KESH në ofrimin e këtyre shërbimeve dhe sigurinë që jep sistemit elektroenergjitik të vendit dhe më gjerë edhe atij të Kosovës, duke ofruar këto shërbime edhe për KOSTT.

Më poshtë pasqyrohet grafikisht ecuria e shërbimeve të balancimit për periudhën 5-vjeçare 2019-2023, ku janë përfshirë, aktivitetet ku përfshihen shërbimet e balancimit si: aktivizim në ngritje/ulje ± mFRR, disbalancat (+/-) dhe grup balancimi:

**Grafiku 18. Shërbimet ndihmëse/balancimit për vitet 2019-2023**




- Totali i volumit të blerjeve të shërbimeve ndihmëse/balancimit për 2023, shkon në 186,159 MWh ose +46% më shumë se 2022, prej 127,812 MWh;
- Totali i volumit të shitjeve të shërbimeve ndihmëse/balancimit për 2023, shkon në 134,101 MWh ose +64% më shumë se 2022, prej 81,998 MWh;

Ky aktivitet i dendur në tregun balancues/ndihmës, i përgjigjet edhe situatës së favorshme hidrike, duke bërë të mundur volume të shtuara në dispozicion të Korporatës, për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Në terma monetarë, të ardhurat neto të krijuara nga ofrimi i shërbimit ndihmëse/balancimit për 2023 janë të konsiderueshme, krahasuar edhe me 2022, kjo për faktin pasi KESH sh.a. përlllogarit çmimin e energjisë balancuese që oferton me çmimin e tregut të energjisë dhe është pjesë e portofolit të optimizimit.

Më poshtë, pasqyrohet grafikisht dinamika e ecurisë së aktivitetit të netuar të KESH për shërbimet e balancimit me OST dhe KOSTT gjatë periudhës 2019-2023:

**Grafiku 19. Të Ardhurat Neto nga shërbimet e Balancimit 2019-2023 (Mln. EUR)**




Nga grafiku më lart, qartësisht dallohet përfitueshmëria gjatë 2023 e aktivitetit të shërbimeve ndihmëse/balancimit, si rezultat i shit-blerjeve me OST dhe KOSTT, në kushtet e një tregu të lirë dhe me objektiv optimizimin ekonomik-financiar, duke shfaqur një aktivitet proaktiv komercial.

- Pjesë e liberalizimit të tregut të shërbimeve ndihmëse që kanë hyrë në fuqi që prej dt. 01.04.2021, dhe si burim i konsiderueshëm të ardhurash në aspektin tregtar, janë edhe shitjet për kapacitete rezervë, të cilat edhe për pasojë të kuotimit të relativisht të larta të çmimeve të energjisë gjatë 2023 kanë arritur vlera të konsiderueshme.

Më poshtë paraqiten të ardhurat nga shitjet për kapacitete rezervë për OST dhe KOSTT 2021-2023:

**Grafiku 20. Shitje rezervim kapaciteti 2021 – 2023 (Mln. Eur.)**




Të ardhurat për këtë shërbim në 2023 rezultojnë 25.05 Mln. Eur. ose rreth +71%, krahasuar me 2022. Përveç vitit pozitiv hidrik 2023, rezultatet pozitive tërësore, aktiviteti tregtar në shërbimet ndihmëse/balancimit, përforcojnë faktin që Korporata përfaqëson operatorin më të sigurt për balancimin dhe sigurinë e sistemit elektroenergjetik jo vetëm për Shqipërinë, por duke përfshirë edhe Kosovën.

- Gjatë vitit 2023 është kryer një menaxhim eficient i portofolit energjetik i orientuar nga sinjalet e çmimeve të tregut duke shfrytëzuar “arbitrage” të çmimeve të kuotuar në tregjet e energjisë

elektrike, për shit-blerje të energjisë elektrike, me qëllim optimizimin e portofolit ekonomik të shoqërisë. Pavarësisht prioritetit për plotësimin e DSHP-së, si rrjedhojë e situatës të favorshme hidrike dhe volumeve optimale nga prodhimi i brendshëm, u krye aktiviteti i kënaqshëm optimizimi ekonomik i portofolit energjitik.

**Tabela 9. Optimizimi i Portofolit Ekonomik 2019-2023**

Transaksionet Komerciale të Optimizimit	2019			2020			2021			2022			2023		
	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)
Blerje energjie elektrike	56,768	46.85	2,659,592	78,366	34.89	2,734,658	95,455	114.93	10,970,313	134,632	26.30	3,541,107	161,288	9.20	1,483,412
Shitje energjie elektrike	42,364	72.20	3,058,611	81,089	49.54	4,016,963	100,968	159.75	16,129,413	91,191	364.60	33,248,585	112,619	159.51	17,964,434
<b>Efekti Financiar Neto nga optimizimi</b>			<b>399,019</b>			<b>1,282,305</b>			<b>5,159,100</b>			<b>29,707,479</b>			<b>16,481,022</b>


**Grafiku 21. Efekti i Optimizimit të Portofolit për vitet 2019-2023 (EUR)**


KESH e mbylli vitin 2023 me rreth 16.48 Mln. Eur neto, prej efektit të optimizimit nga transaksionet në tregun e lirë me një diferencë/marzh çmimi mesatar mjaft të kënaqshëm prej 150.32 Eur/MWh. Pothuajse i gjithë optimizimi, vjen nga aktiviteti i tregtar të energjisë me shoqëritë OST e KOSTT për shërbimet ndihmëse/balancimit.

- Në lidhje me shitjet për humbjet në transmetim, VKM nr 456, datë 29.06.2022, ngarkon KESH sh.a. për të mbuluar humbjet e rrjetit të transmetimit në periudhën e gjendjes së emergjencës. Në kushtet e mësipërme, shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a. nënshkruan kontratën mes paleve, e cila u miratua nga Bordi i ERE. Duhet evidentuar që prej çeljes së Prillit 2023, shitja e humbjeve në rrjetin e transmetimit kryhet nëpërmjet ALPEX. Koncretisht për vitin 2023, shoqëria KESH sh.a. ka furnizuar shoqërinë OST sh.a. për sasinë e konsiderueshme prej 216,554 MWh energji, me një vlerë shitje prej gati 20.26 Mln. Eur. Në lidhje me KOSTT gjatë vitit 2023, Korporata nuk ka patur shitje për humbjet në transmetim.

Më poshtë paraqitet grafikisht ecuria në volume dhe vlerë për periudhën 2019-2023:

**Grafiku 22. Ecuria për Shitje Humbje Transmetimi (2019-2023)**



Referuar grafikut të mësipërm, volumet nga shitjet humbje transmetimi gjatë vitit 2023, ishin gati 2.4x më të larta se viti 2022. Po kështu të ardhurat nga këto shitje rezultuan 3x më të larta se 2022. Kjo si rezultat, jo vetëm i sasisë më të lartë, por edhe sepse çmimi mesatar i shitjes së humbjeve në transmetim gjatë 2023 ishte 93.54 Eur/MWh, ose gati +20 Eur/MWh më i lartë, krahasuar me 2022 prej 73.6 Eur/MWh. Pra, aktiviteti tregtar edhe në shitjet për humbje transmetimi, ka rezultuar dinamik dhe burim i konsiderueshëm të ardhurash komercial për Korporatën.

## 6. AKTIVITETI INVESTUES 2023

### 6.1 REALIZIMI I INVESTIMEVE

Në lidhje me investimet gjatë vitit 2023, Korporata është treguar mjaft e kujdesshme në menaxhimin e fondeve. Kjo jo vetëm për arsye e gjendjes së emergjencës në sektor, në zbatim të kushteve ligjore, por dhe politikave të brendshme për menaxhimin me efijencë të kostove në tërësi, duke përfshirë edhe investimet. Gjithsesi ndryshe nga viti 2023, aktiviteti pozitiv i operimit dhe i tregtimit gjatë 2023, siguroi kushte më pozitive financiare (flukseve hyrëse monetare), të cilat e ndihmuan aktivitetin investues, duke mundësuar jo vetëm investimet e nevojshme/të domosdoshme, të cilat sigurojnë një aktivitet normal të shoqërisë, por edhe ato me trajtë përmirësuese dhe zhvilluese të aktivitetit të shoqërisë. Kryesisht, investimet janë përqendruar në investime rinovuese kapitale të nevojshme për sigurinë e veprave, për aktivitetin e operim/shfrytëzimit dhe në infrastrukturën kritike të teknologjisë dhe informacionit.

Në total realizimi i investimeve gjatë 2023 ka kapur vlerën e mbi 3.8 Mld. Lek. Krahasuar me Planin Ekonomik të Rishikuar 2023 prej gati 7.2 Mld. Lek, investimet janë realizuar në masën rreth 53%. Por, krahasuar me vitin 2022 prej 2.75 Mld. Lek, gjatë 2023 janë realizuar +1.06 Mld. Lek ose +38.3% më shumë investime. Politika investuese e Korporatës është fokusuar në sigurinë dhe efijencën e veprave hidrike, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të investimeve pasi asetet gjeneruese aktuale, për vetë

madhësinë dhe problematikat e amortizimit të tyre në vite, kanë nevojë për investime mirëmbajtëse/rinovuese dhe modernizuese periodike.

Ndërkohë, fokusi është shtuar edhe tek zhvillimi i qëndrueshëm strategjik nëpërmjet investimeve në kapacitete të reja dhe të diversifikuara të BRE, me projekte konkrete për zbatim në këtë fushë.


Tabela e mëposhtme, pasqyron në mënyrë të përmbledhur, realizimin e investimeve sipas burimit të financimit dhe sipas njësive:

**Tabela 10. Realizimi i Investimeve për vitet 2017-2023**

VLERA E INVESTIMEVE TË REALIZUARA	2023	2022	2021	2020	2019	2018	2017
Investimet e vetë financuara (Mln. lekë)	2,675	2,325	3,347	2,262	384	1,459	3,256
Investimet me financim të huaj (Mln. lekë)	1,132	427	1,072	1,146	883	917	1,223
<b>Total</b>	<b>3,807</b>	<b>2,752</b>	<b>4,419</b>	<b>3,408</b>	<b>1,267</b>	<b>2,376</b>	<b>4,478</b>
Investimet sipas Njësive (Mln. lekë)	Fierzë	819	142	785	822	122	1,603
	Koman	138	288	990	1,813	895	1,590
	Vau Dejës	1,903	531	828	422	107	1,165
	Aparati Qëndror	947	1,791	1,816	351	143	120

- Shpërndarja e Investimeve të realizuara për 2023, sipas njësive/qendrave të kostos, u shpërndanë përkatësisht në HEC Fierzë 21%; HEC Koman 4%; HEC ViD 50% dhe KESH Qendër në 25%. HEC ViD zë 50% të totalit të investimeve të realizuara për 2023, kjo për arsye të përqendrimit të investimeve me fonde të huaja për rehabilitimin e shkarkuesve të këtij HEC, në kuadër të “Programit të Sigurisë së Veprave Hidrike”. Më poshtë grafiku përkatës:

**Grafiku 23: Realizimi i Investimeve për 2023 sipas Njësive (në /Mln. Lek)**




- Referuar grafikut të mëposhtëm, burimi i financimit të investimeve realizuara prej 3.8 Mld. Lek ndahet në raportin 70% nga fondet e brendshme të Korporatës, kundrejt 30% me fonde të huaja. Gjatë vitit 2023, ky raport në 2023 është më e ekuilibruar, krahasuar me vitin 2022, ku kjo ndarje ishte përkatësisht në 84% i financimit me fondet e vetë Korporatës dhe 16% me financim të huaj. Edhe burimet e realizimit të investimeve gjatë 2023, kanë pasur rritje të brendshme krahasuar me 2022.

Konkretisht investimet me fondet e veta gjatë 2023, janë realizuar me 2.675 Mld. Lek ose me rritje + 350 Mln. Lek, ose +15% më shumë, krahasuar me 2022, prej 2.325 Mld. Lek.

Gjithashtu, investimet me financimet e huaja gjatë 2023, janë realizuar me 1.132 Mld. Lek ose rritje + 706 Mln. Lek, ose 2.65x më shumë, krahasuar me 2022, prej vetëm 427 Mln. Lek. Me fillimin e


projektit të Rehabilitimit Elektro-Mekanik të HEC Fierzë, ky burim financimi do të rritet ndjeshëm në të ardhmen.

**Grafiku 24. Realizmi i Investimeve sipas Burimit të Financimit 2017-2023**



- Në lidhje me qëllimin e realizimit të investimeve, ato ndahen në 3 drejtime kryesore si më poshtë:
    - Garantimi i sigurisë së veprave;
    - Rritja e efijencës në prodhim, ku përfshihen edhe shtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese;
    - Përmirësimi i kushteve të punës.
- Ndarja e investimeve të realizuara gjatë 2017-2023, sipas kategorive paraqitet grafikisht më poshtë:

**Grafiku 25. Realizmi i Investimeve për vitet 2017-2023**



Nga grafiku i mësipëm vërehet se në periudhën 2017-2021, volumi më i madh i fondit të investimeve është alokuar për rritjen/garantimin e sigurisë së veprave. Ndërsa gjatë 2022-2023 realizimi më i madh ka kaluar tek rritja e eficiencës së prodhimit/kapacitetet e reja.

Kjo për 2 arsye kryesore:

- Ashtu si theksuam edhe më lart, duke qenë se garantimi i sigurisë së veprave është i lidhur më së shumti me Projektin e Sigurisë së Veprave Hidrike, i cili është drejt finalizimit, prandaj edhe për vitin 2023, kjo kategori investimesh ka pasur një peshë më të vogël;
- Objektivi i Rritjes së Eficiencës/kapacitetet e reja ka zënë peshë më të madhe gjatë 2023, pasi pjesa më e madhe e investimeve janë të tipit investues-rinovues në linjat elektro-mekanike, investime në fushën e teknologjisë dhe informacionit dhe në rritjen e kapaciteteve të reja.

Gjatë vitit 2023, 68% e investimeve kategorizohen me objektivi “Rritja e Eficiencës/Prodhimit”, 31.5% kategorizohen me objektivi “Rritja e Sigurisë së Veprave Hidrike” dhe 0.5% për “Përmirësimin e kushteve të punës”.

## 6.2 INVESTIMET E ME FONDET E HUAJA

Investimet e financuara nga partnerët ndërkombëtar, përfshihen në “Programin e Sigurisë së Veprave Hidrike”, që ndryshe njihet si “Projekti i Sigurisë së Digave”. Projekti financohet paralelisht nga disa institucione ndërkombëtare financiare si Banka Botërore (WB), Sekretariati Shtetëror i Bashkëpunimit Financiar Zviceran (SECO), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Banka Botërore ka rolin e udhëheqësit ndër këto institucione të cituara më lart. Projekti është në mbyllje të tij. Gjatë vitit 2023, në kuadër të këtij programi, janë realizuar investimet e mëposhtme:

- *Rehabilitimi i Portave të Shkarkimit të HEC Vau i Dejës*

U përzgjedh Konsulenti i zbatimit të projektit kompania e njohur Fichtner GmbH Gjermani, e cila asistoi në kontraktimin për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC Vau i Dejës dhe mbikqyrjen e zbatimit të projektit. U krye rehabilitimi e portave të mirëmbajtjes dhe shkarkimit në HEC ViD, të cilat përfunduan me sukses dhe në afate, duke përfshirë edhe testimin e tyre, brenda vitit 2023. Investimi u financua nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), i cili kapi vlerë totale Konsulenti i zbatimit + zbatim i projektit = 17.2 Mln. Eur.

- *Implementimi i Qendrës së Kontroll-Monitorimit të Kaskadës së lumit Drin.*

Konsulenti i zbatimit të këtij investimi ka realizuar procedurat kontraktuale. Kontrata u zbatua sipas parashikimeve kontraktuale. Ndërkohë kontraktori i zbatimit të projektit realizoi kontratën pa problematika dhe brenda afateve, duke përfunduar investimin përfundoi në 2023. Tashmë, Korporata ka një qendër moderne kontroll-monitorimi të integruar të Kaskadës së lumit Drin. Edhe ky investim, u financua nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), i cili kapi vlerë totale Konsulenti i zbatimit + zbatim i projektit = 2.8 Mln. Eur.

- *Projekti për rehabilitimin Elektro-Mekanik të HEC Fierzë*

Në bazë të ligjit Nr. 69/2021 datë 20.5.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Rehabilitimi i HEC Fierzë”.

Marrëveshja e huasë në shumën 40 Mln. EUR ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Korporatës Elektroenergetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main për rehabilitimin Elektro-Mekanik të HEC Fierzë ratifikuar me ligjin nr 44/2022 datë 28.04.2022 ka hyrë në fuqi më datë 28.05.2022 dhe është bërë efektive më datë 23.08.2022.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje u sigurua një kredi e butë nga Banka Gjermane e Zhvillimit (KfW) e cila do të shkojë për rehabilitimin e plotë elektro-mekanik të HEC Fierza. Përveç kredisë nga Banka

Gjermane e Zhvillimit KfW, nëpërmjet programit WBIF u akordua edhe një grant prej 8.35 Mln. EUR nga BE për këtë projekt.

Marrëveshja e Grantit shoqëruet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, KfW Frankfurt am Main dhe KESH sh.a. për shumën 2 Mln. EUR, për masat shoqëruese rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës. Në Total projekti kap vlerën e financimit *50.35 Mln. EUR = 40 Mln. EUR Kredi + 10.35 Mln. EUR Grant.*

Kontrata me konsulentin e zbatimit tashmë është realizuar. Konsulenti i Zbatimit për këtë aktivitet është përzgjedhur kompania Zviceriane AFRY, kontrata e të cilës është në zbatim.

Gjatë vitit 2023 është disbursuar shuma prej 66,730 Euro. Financimi i projektit do të jetë i vlefshëm deri më 30.03.2028. Procedura për zbatimin e punimeve rehabilituese elektro-mekanike është në fazë tenderimi.

Ky projekt madhor ka rëndësi shumë të madhe si për mirëmbajtjen ashtu si dhe për sigurinë dhe cilësinë e prodhimit, pasi lidhet me rehabilitimin Elektro-Mekanik të hidrocentralit të sipërm të rrjedhës dhe rregullator të gjithë kaskadës së Drinit, me një impakt thelbësor në menaxhimin operacional të prodhimit.

### 6.3 INVESTIMET ME FONDET E VETA

1. Si pasojë e gjendjes së emergjencës në sektor, pavarësisht se i favorshëm hidrik, edhe viti 2023 pati kufizim në realizimin e investimeve. Pavarësisht këtyre vështirësive investimet në monitorimin/vlerësimin e veprave hidroteknike dhe disa në rritjen e sigurisë tyre u arritën të realizohen. Gjatë vitit 2023, ndër investimet më kryesore të Korporatës në funksion të sigurisë së veprave hidroteknike të përfunduara ose në proces përmendim në vijim:
  - Batimetria e liqenit të Fierzës, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore;
  - Rehabilitimi i galerisë së çimentimit në kuotën 296 mmnd në shpatullën e majtë të digës Fierzë dhe e rrugës së saj të aksesit;
  - Mbrojtja me prita malore e përroit të Lekbibaj në HEC Fierzë;
  - Mbilartërsimi i mbrojtjes lumore përballë tuneleve të shkarkimit dhe sistemimi i sheshit pranë magazinës së re në HEC Fierzë;
  - Batimetria e liqenit të Komanit, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore;
  - Rikonstruksioni godinës së gatishmërisë HEC Koman (sistemim i brendshëm dhe i jashtëm);
  - Zëvendësim i tubacioneve dhe paisjeve të sigurisë për sistemin e shkarkimit të ujrave të drenazheve në bjefin e poshtëm në HEC ViD;
  - Batimetria e liqenit të Vaut të Dejës, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore;
  - Mbrojtja e shpatit të djathtë të digës së Qyrfaqit mbi rrymëshpejtuesin;
  - Ndërtim shtrese dyshemeje tek salla e turbinave;
2. Me fondet e vetë Korporatës janë kryer ose janë në vazhdimësi investime të profilit elektro-mekanike të karakterit riparues/rinovues dhe përditësues si:
  - Riparimi i dëmtimeve të turbinave të AG1 dhe AG3;
  - Rinovimi i sistemit të mbrojtjes së 2 agregatëve HEC Fierzë me furnizim instalimin/konfigurimin të dy paneleve të reja, i kompletuar me mbrojtjet dixhitale për gjeneratorin dhe të releve një veprimëshe;
  - Blerje pajisje matëse portative profesionale për matjen e tangent deltës dhe kapacitetit (DF&C) dhe trajnim i avancuar (know-how) nga prodhuesi;
  - Ndërhyrje në sistemin e ngrohje-ftohjes së salles së makinave në HEC Fierzë për të instaluar kaldaja elektrike;
  - FV 2 çelësa 3 polar, 245 KV, me gaz SF6, për seksionin e parë të zbarave në N/Stacionin 220 kV e HEC Fierzë dhe sistem monitorimi të parametrave për 3 çelësat e tjerë;
  - F.V. 12 copë ndarësa 220kV për blloqet e 4 (katër) agregatëve, seksioni i parë në N/Stacionin 220kV Fierzë;

- FV impiant i ri 0,4 kV i nevojave vetiake të përgjithshme te centralit HEC Koman, me dy hyrje 3,200A dhe seksionator me automatike change-over e mbrojtje termomagnetike, daljet me kontroll manual 400A dhe 800/1,000A, pajisur me mbrojtje termomagnetike;
  - Furnizim & Instalim Inverter industrial 125VDC/230VAC me kapacitet 4.5 kVA, Furnizim & Instalim i kablove dhe kanalave metalike për sistemimin e linjave dalëse që do të furnizojnë sistemet e monitorimit të HEC Koman;
  - Ndërtimi i kanalit dhe i linjave të furnizimit 6kV nga N/Stacioni. 35/6 kV deri në Central me FV kablo të ri 6kV në HEC Koman;
  - Rehabilitim i dëmtimeve të turbinave të 5 (pesë) agregatëve në HEC ViD;
  - Rinovimi i sistemit të mbrojtjes së 3 agregatëve me instalim/konfigurim të releve të reja dixhitale në vend të releve ekzistuese REG, RET dhe funksioneve të releve një veprimëshe dhe upgrade për sistemin e mbrojtjeve për 2 agregatët e tjerë në HEC ViD;
  - FV 1 (një) çelës 3 polar 245 KV, me gaz SF6 për bllokun e AG2 dhe sistem monitorimi për parametrat e 5 çelësave në HEC ViD;
  - Rinovimi i sistemit të monitorimit të vibrimeve të turbinave dhe instalimi i sistemit të ri të monitorimit air gap për 5(pesë)agregatët, si dhe integrimi i sinjaleve dalës nga sistemi i ri qendror tek inputet ekzistuese të sistemit të kontrollit për 5(pesë) agregatët e HEC ViD.
3. Në fushën e Automatizimit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për shkak të situatës kibernetike në rajon janë ndërmarrë një sërë masash të kombinuara edhe me investime për të akomoduar këto çështje në kuadër të rritjes së përshtatshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Investime kryesore me karakter monitorues-integrues mund të përmendim:
- Riorganizimi i dhomës së Serverave në Qendër ose në njësi;
  - Përmirësimi i infrastrukturës së aksesit Wireless dhe rritja e nivelit të sigurisë e administrimi i qendëruar i aksesit në rrjetat e komunikimit të KESH sh.a.;
  - Implementimi i inteligjences artificiale për operimin e kaskadës parashikimit të prurjeve dhe menaxhimin e shkarkimeve;
  - Blerje pajisje informatike për përdoruesit e KESH sh.a.;
  - Mirëmbajtja e sistemeve të monitorimit të transformatorëve të fuqisë DGA, BMT të HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC ViD për një periudhë 4-vjeçare;
  - Blerje pajisje testuese profesionale, me injektim në sekondar për testimin e funksioneve të mbrojtjeve elektrike dhe trajnim i avancuar për testimin e mbrojtjeve të gjeneratorëve dhe të transformatorëve dhe kalibrim i pajisjeve testuese ekzistuese në KESH sh.a.

Objektivat për vitin 2024 është vazhdimi për përafrimin e standarteve dhe certifikimi drejt ISO 27001 mbi sistemet operacionale, duke ndihmuar Departamentin e Automatizimit dhe TIK dhe Korporatës të ketë procedura, rregullore të qarta dhe funksionale për të siguruar të gjithë aktivitetin teknologjik, duke evidentuar çdo rrezikshmëri kibernetike si faktor kyç për infrastrukturën kritike.

#### **6.4 ECURIA E PROJEKTEVE BRE**

Si objektivi i rëndësishëm i zhvillimit strategjik dhe të qëndrueshëm i Korporatës është edhe rritja e kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet burimeve të diversifikuara. Kjo strategji e ndjekur nga Korporata është në linjë me politikat kombëtare të vendosura nga Qeveria Shqiptare, dhe bazuar në dokumentin “Zhvillimi i Strategjik i Sektorit Energjetik”, përgatitur nga CMA dhe Growth Lab të Universitetit të Harvardit. Ky dokument përfaqëson një udhërrëfyes, i cili shpalos rrugët konkrete për një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë dhe të integruar të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar, ku KESH sh.a. si një aktor qendror i sektorit, ka rol kryesor.

Është për tu evidentuar aktivitetet gjenerues i impiantit PV me fuqi të instaluar prej 5.143 MW, i instaluar në digën e Qyrsaqit-HEC ViD, si i pari burim i diversifikuar jo-hidro në portofolin gjenerues të Shoqërisë. Kjo ishte një arritje për Shoqërinë dhe në funksion të objektivit afatgjatë zhvillimor të rritjes së kapaciteteve gjeneruese nëpërmjet diversifikimit, i cili do të pasohet shpejt nga BRE të tjera. Impianti

filloi zyrtarisht prodhimin më 12 Maj 2022. Gjatë vitit 2022 ky impiant prodhoi 4,203 MWh energji elektrike me faktor kapaciteti 14%. Ndërkohë, për periudhën e operimit 2023, impianti PV Diga Qyrsaq ka gjeneruar 7,541 MWh me faktor kapaciteti mjaft të kënaqshëm prej gati 16%.

Pavarësisht vështirësive si rezultat i gjendjes së emergjencës, gjatë vitit 2023, është për tu evidentuar avancimi i projekteve të Korporatës për shtimin dhe diversifikimin e kapaciteteve të reja të burimeve të rinovueshme të energjisë, fokusuar më së shumti tek energjia diellore.

- Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltaiik lundrues 13.8 MWp në liqenin e ViD:

Zhvillimi i këtij projekti po realizohet në bashkëpunim të ngushtë me BERZH, e cila ka lidhur marrëveshjen e angazhimit për financimin e këtij projekti nëpërmjet një kredie tregtare. Po kështu është u nënshkruar marrëveshja e kredisë ndërmjet kompanisë së projektit SENA sh.a., sponsorit KESH sh.a. dhe BERZH, si dhe gjithashtu ka përfunduar procesi për përzgjedhjen e supervizorit. Aktualisht ka përfunduar procesi i tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit dhe është në fazë vlerësimi i aplikimeve. Po kështu projekti ka fituar një mbështetje financiare në formë granti, në kuadër të programit financues të WBIF-EIP. Gjatë vitit 2024 do të nënshkruhet marrëveshja me kontraktorin dhe marrëveshja për grantin. Projekti është në fazën projektimit të detajuar teknik dhe më pas zbatimi.

- Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltaiik 8.25 MWp në digën e Zadejës të HEC ViD:

Gjatë vitit 2023 u nënshkrua kontrata me instalatorin. Kontrata është e tipit "turn-key" (me çelësa në dorë). Në fund të 2023, kontraktori dorëzoi projektin e zbatimit të impiantit PV. Aktualisht projekti është në fazën e miratimit dhe marrjeve të lejeve përkatëse për të vijuar me ndërtimin. Objektivat dhe rëndësia e këtij projekti janë të njëjta me projektin e impiantit fotovoltaiik në digën e Qyrsaqit.

- Projekti për impiantin foftovoltaiik 50 MWp në zonën Belsh:

Ky është një projekt në shkallë të gjerë dhe me impakt që synon diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike. Gjatë 2023, u zhvillua procesi i studimi social mjedisor nga kompania Alpage SRL. Në Dhjetor 2023 përfundoi procesi i studimit të fizibilitetit nga kompania Tractebel Engineering GmbH. Gjithashtu Tractebel ka përgatitur Basic Electrical Design, si dhe Minimum Functional Specifications si pjesë e specifikimeve teknike për tenderim. Aktualisht për zhvillimin e këtij projekti është angazhuar për ta financuar BERZH, nëpërmjet një kredie me terma preferencial (me garanci sovraane) si dhe nëpërmjet një granti për asistencë teknike për realizimin e studimeve dhe projektit teknik. Gjithashtu projekti ka fituar në programin e WBIF-EIP për një grant për investimin. Viti 2024, parashikon përfundimin e fazës para-ndërtimore.

- Projekti për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës:

Faza I e kontratës me Kompaninë Bechtel përfshin ESIA+Basic Design+Studim Fisibiliteti. Sipas parashikimit pritet që deri në mesin e 2024 të përfundojnë aktivitetet kryesore të Fazës I dhe më pas të fillojnë përgatitjet për Fazën II të kontratës. Faza e II e projektit parashikohet të vijohet në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 38/2021. Referuar vlerësimit të rezultateve të Fazës I, parashikohet që Faza II që përfshin projektimin e detajuar+kontrata e ndërtimit+zbatimi i projektit, të fillojë në fund vitit 2024. Koha e ndërtimit rreth 5 vite.

## **7. AKTIVITETI EKONOMIKO-FINANCIAR PËR VITIN 2023**

### **7.1 AKTIVITETI I OPERACIONEVE TË VIJUESHËM**

Ashtu si u evidentua edhe më lart, viti 2023, rezultoi vit i favorshëm hidrik duke stimuluar aktivitet shfrytëzues dhe gjenerues të shtuar. Kjo reflektoi, edhe në aktivitetin e shtuar komercial duke dhënë rezultate pozitive operativo-ekonomike për periudhën. Korporata arriti të përballojë më me lehtësi dhe siguri përgjegjësitë ndaj situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike. Po kështu edhe situata e stabilizuar e tregjeve të energjisë me çmime ndjeshëm më të ulura dhe ekspozim të ulët, favorizuan një aktivitet ndjeshëm pozitiv gjatë 2023, dhe në kontrast të plotë me vitin e vështirë 2022.

Pavarësisht situatës pozitive, Korporata u kujdes maksimalisht, duke zhvilluar aktivitetin mbështetur mbi parimet e optimizimit dhe menaxhimit eficient të kostove.

Më poshtë jepen indikatorët kryesorë të aktivitetit ekonomik për vitin 2023 dhe krahasimi i tyre me mesataren 5 vjeçare 2018-2022.

Duhet theksuar që të dhënat ekonomiko-financiare të paraqitura në këtë kapitull janë të stadiit operacional dhe për rrjedhojë të paçertifikuara ende nga audituesit.

**Tabela 11. Treguesit kryesorë të veprimitarisë ekonomike 2018-2023**

Treguesit e Aktivitetit Ekonomik	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Mesatarja 5-vjeçare (2018-2022)
Prodhimi Neto nga KESH sh.a (GWh)	5,131	3,860	5,346	3,090	2,979	5,851	4,225
<b>Të Ardhura ('000 Lekë)<sup>1</sup></b>	<b>38,366,097</b>	<b>36,609,329</b>	<b>18,904,679</b>	<b>11,366,643</b>	<b>9,910,229</b>	<b>18,396,176</b>	<b>19,037,411</b>
Fitimi / (Humbja) neto për periudhën ('000 Lekë)	17,053,377	-25,818,100	6,003,405	2,087,198	1,863,170	10,391,871	-1,094,491
Llogari të Pagueshme ('000 Lekë)	22,801,193	25,332,173	35,691,379	41,852,854	48,136,620	39,782,769	38,159,159
Llogari të Arkëtueshme ('000 Lekë)	75,745,231	72,685,314	57,967,812	62,113,518	57,662,140	64,527,159	62,991,189
<b>Shpenzimet Fikse Operacionale ('000 Lekë)<sup>2</sup></b>	<b>2,311,134</b>	<b>2,295,441</b>	<b>2,217,636</b>	<b>2,049,910</b>	<b>1,819,613</b>	<b>1,790,946</b>	<b>2,034,709</b>
<b>Shpenzime Operative (Lekë/GWh)</b>	<b>450</b>	<b>595</b>	<b>415</b>	<b>663</b>	<b>611</b>	<b>306</b>	<b>518</b>

1) Të ardhurat përbëjnë shitjet për Klientët tariforë të OSHEE, shitje në tregun e parregulluar dhe optimizim. Tek Shërbimet ndihmëse dhe të balancimit. Tek rubrika të ardhura të tjera përfshihen të ardhura ekstra bazuar në kontrata mbi energjinë elektrike (si kamatvonesa, penalitete etj.)

2) Shpenzimet operative fikse lidhen vetëm me aktivitetin operacional të shoqërisë duke zbritur zhvlerësimin/amortizimin dhe blerjet e energjisë.

Referuar të dhënave në tabelën e mësipërme, treguesit kryesorë vlerësohen shkurtimisht si më poshtë:

- Të ardhurat totale 38.37 Mld. Lek konsistojnë në: rreth 32.52 Mld. Lek nga shitja e energjisë në tregun e rregulluar për përmbushjen e DSHP, tregun e parregulluar, optimizim, shitje humbje transmetimi dhe disbalanca. Shërbimet ndihmëse/balancimit energjetik janë 4.62 Mld. Lek, dhe “Të ardhurat të tjera” prej 1.22 Mld. Lek ku përfshihen të ardhura ekstra, përbëhet pothuajse nga të ardhurat nga diferenca e çmimit nga shitjet në Alpex për OST dhe FSHU (1.2 Mld. Lek);
- Rezultati neto për periudhën është në vlerën mbi 17.05 Mld. Lek, ndikuar nga të ardhurat e konsiderueshme nga aktiviteti energjistik dhe shpenzimet e reduktuara nga po ky aktivitet. Referuar tabelës, rezultati i 2023 është më pozitiv i periudhës 2018-2023, duke kaluar edhe vitin më të mirë në prodhim 2018;
- Vlen të theksohet se indikator “Shpenzimet Operative Fikse/GWh të prodhuar” është në vlerën 450 Mijë Lek/GWh të prodhuar, duke rezultuar më i ulët se mesatarja 2018-2022 prej 518 Mijë Lek/GWh. Kjo tregon rritje të efijencës operacionale-ekonomike dhe menaxhim adekuat të kostove të përgjithshme fikse të aktivitetit;
- Si tregues i vlerësimit të likuiditetit, vërehet se “Llogaritë e Arkëtueshme” në fund të 2023 janë rritur me mbi 3 Mld. Lekë (+4%), krahasuar me 2022, duke vazhduar të ndikojë negativisht në likuiditetin e Korporatës dhe cënon zhvillimin ekonomiko-financiar, sidomos aktivitetin investues të saj;
- Si tregues i vlerësimit të aftësisë paguese (solvency), vërehet se “Llogaritë e Pagueshme” në fund të 2023 janë ulur me -2.53 Mld. Lek (ose -10%), krahasuar me 2022. Ulja e këtij zëri, tregon rritjen e aftësisë paguese të Korporatës si pasojë e rritjes së cash-flow nga aktiviteti operativ pozitiv gjatë 2023. Ndërkohë tregon edhe angazhimin maksimal të Korporatës, për uljen e detyrimeve afatshkurtra. Gjithsesi ky angazhim, nuk reflektohet në të njëjtën masë nga aktorët e tjerë të sektorit, pasi vazhdojnë dukurinë që të mos paguajnë disa zëra detyrimesh ose paguajnë pjesërisht detyrimet ndaj KESH, duke çuar në rritjen e vlerës agregate të “Llogaritë të Arkëtueshme”. Kjo ndikon negativisht duke kushtëzuar flukset hyrëse të likuiditetit aq të nevojshëm për soliditetin ekonomiko-financiar të Korporatës.

Tabela 12. Pasqyra Operacionale e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve 2023


(Shumat janë të shprehura në mijë lekë)	PL_PEF 2023 (i Rishikuar)	PL 2023 Realizimi (Operacional)	Ndryshimi në vlerë (Realizim 2023 vs PEF i Rishikuar 2023)	Ndryshimi në % (Realizim 2023 vs PEF i Rishikuar 2023)
<b>Operacionet e vijueshëm</b>				
- Të ardhura nga shitja e energjisë:	<b>38,980,896.30</b>	<b>37,147,963.30</b>	<b>(1,832,932.99)</b>	<b>-4.70%</b>
Shitje energjie elektrike për klientët fundorë të lidhur në nivel tensioni 0.4 KV	11,290,252.42	9,091,505.91	(2,198,746.51)	-19.47%
Shitje energjie ekektrike për klientët në TM 6/10/ 20 KV	3,012,220.60	3,624,975.44	612,754.84	20.34%
Shitje energjie elektrike për shoqëritë UK në TM 6/10/20/ 35 KV	1,047,101.23	1,011,018.88	(36,082.35)	-3.45%
Shitje energjie elektrike për shoqëritë në nivel tensioni 35 KV	1,199,731.75	204,065.28	(995,666.47)	-82.99%
Shitje energjie elektrike për humbjet e Transmetimit OST	669,112.02	676,362.02	7,250.00	1.08%
Shitje energjie elektrike për humbjet e Transmetimit KOSTT	-	-	-	0.00%
Shitje energjie elektrike për eksport / Optimizim Energjie	2,780,136.95	6,199,529.35	3,419,392.40	122.99%
Shitje energjie elektrike - OST Disbalanca pozitive	71,922.75	41,992.70	(29,930.05)	-41.61%
Të Ardhura të tjera nga faturim shtesë FSHU	949,761.12	2,848,164.78	1,898,403.66	199.88%
Shitje në ALPEX për humbjet OST	2,184,046.31	1,564,824.85	(619,221.46)	-28.35%
Shitje në ALPEX për FSHU / FMF	10,806,943.27	7,248,457.02	(3,558,486.25)	-32.93%
Shitje AlpeX (tregtare I regjistruar ne Burse)	-	8,147.37	8,147.37	100.00%
Të Ardhura të tjera energjie elektrike (rezerva ne rritje OST)	3,610,383.18	3,434,612.24	(175,770.95)	-4.87%
Të Ardhura të tjera energjie elektrike (rezerva ne rritje KOSTT)	1,355,194.38	1,188,618.39	(166,575.99)	-12.29%
Te Ardhura te tjera ( Ashta <sup>ç</sup> Noa)	4,090.31	5,689.07	1,598.76	39.09%
- Të ardhura të tjera operacionale	-	1,218,133.95	1,218,133.95	100.00%
<b>Shuma e të Ardhurave Operative</b>	<b>38,980,896.30</b>	<b>38,366,097.26</b>	<b>(614,799.04)</b>	<b>-1.58%</b>
- Materiale të para dhe të konsumueshme	<b>203,310.00</b>	<b>111,813.09</b>	<b>91,496.91</b>	<b>-45.00%</b>
- Blerje Energjie:	<b>21,055,704.65</b>	<b>17,079,293.17</b>	<b>3,976,411.48</b>	<b>-18.89%</b>
Blerje Energjie Elektrike me çmime tregu (import dhe tregu vendas)	15,007,859.88	6,505,574.31	8,502,285.57	-56.65%
Blerje Energjie Elektrike për optimizim (import dhe tregu vendas)	-	-	-	0.00%
Kompesimi financiar për FTL për energjinë e pakthyer nga depozitimi	1,152,927.00	9,755,983.65	(8,603,056.65)	746.19%
Kompesim financiar për OST (çmimi i bursës - çmimin e rregulluar)	908,418.87	209,732.23	698,686.63	-76.91%
Kompesim financiar për FSHU (çmimi i bursës - çmimin e rregulluar)	3,567,809.22	299,341.75	3,268,467.46	-91.61%
Blerje energji elektrike – ALPEX-Tregtar I regjistruar ne Burse	-	15,468.54	(15,468.54)	100.00%
Blerje energjie nga Karavasta Solar Çmimi I rregulluar	-	2,970.99	(2,970.99)	100.00%
Tarifë Transmetimi	6,916.22	4,044.45	2,871.78	-41.52%
Blerje Energjie për mbulimin e Disbalancave	221,179.43	124,464.07	96,715.36	-43.73%
Blerje Shërbime ndihmëse OST	185,247.32	161,665.35	23,581.96	-12.73%
Blerje Shërbime ndihmëse KOSTT	5,346.72	47.83	5,298.89	-99.11%
Shpenzime te tjera energjie elektrike	-	-	-	0.00%
Shpenzime personeli	<b>1,432,871.25</b>	<b>1,277,593.92</b>	<b>155,277.33</b>	<b>-10.84%</b>
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	<b>4,235,830.00</b>	<b>4,067,334.62</b>	<b>168,495.38</b>	<b>-3.98%</b>
Shpenzime aseti gjenerues termik	<b>8,882,326.00</b>	<b>7,378.68</b>	<b>8,874,947.32</b>	<b>-99.92%</b>
Shpenzime të tjera operacionale	<b>1,383,659.70</b>	<b>931,106.22</b>	<b>452,553.48</b>	<b>-32.71%</b>
<b>Shuma e Shpenzimeve Operative</b>	<b>37,193,701.60</b>	<b>23,474,519.69</b>	<b>13,719,181.91</b>	<b>-36.89%</b>
<b>Fitimi Operativ</b>	<b>1,787,194.70</b>	<b>14,891,577.56</b>	<b>13,104,382.87</b>	<b>-733.24%</b>
Të ardhura financiare	130,397.88	6,767,749.18	6,637,351.30	5090.08%
Shpenzime financiare	(687,065.42)	(1,596,530.29)	909,464.87	132.37%
<b>Shpenzime Financiare Neto</b>	<b>(556,667.54)</b>	<b>5,171,218.89</b>	<b>(5,727,886.43)</b>	<b>-1028.96%</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>1,230,527.16</b>	<b>20,062,796.46</b>	<b>18,832,269.30</b>	<b>1530.42%</b>
Kreditim i tatimit mbi fitimin	-	-	-	-
Shpenzime tatim fitimi	(184,579.07)	(3,009,419.47)	2,824,840.40	1530%
<b>Fitimi neto i periudhës nga operacionet e vijueshëm</b>	<b>1,045,948.08</b>	<b>17,053,376.99</b>	<b>16,007,428.91</b>	<b>1530%</b>

Tabela e mësipërme përmbledh aktivitein operativ nëpërmjet Pasqyrës P/L Operacionale të Realizuar 2023, krahasuar me PEF të Rishikuar 2023, ku në rubrikat evidentohen:

- Të Ardhurat totale të realizuara prej 38.37 Mld. Lek, janë pothuajse të njëjta me PEF të Rishikuar prej 38.98 Mld. Lek (vetëm -1.58% më pak);
- Shpenzimet totale të periudhës rezultojnë 23.47 Mld. Lek, me një ulje të ndjeshme me -37%, nga PEF i rishikuar, prej 37.19 Mld. Lek. Kjo jo vetëm si rezultat i aktivitetit blerës të energjisë i cili u reduktua me gati -19%, por edhe i qasjes së menaxhimit eficient të kostove të përgjithshme të aktivitetit. Veçojmë faktin që shpenzimet tjera të aktivitetit si: “Materiale të Para dhe të Konsumueshme” (-45%), “Shpenzime Personeli” (-11%), “Shpenzime të tjera Operacionale” (-33%) etj., janë më të ulta se PEF i rishikur, duke kontribuar ndjeshëm në uljen e kostove të aktivitetit.
- Veçojmë se aktiviteti operacional financiar rezultoi me marzh neto prej 5.17 Mld. Lek ose gati +9.3x më të larta se PEF i Rishikuar, pothuajse i gjithi nga "fitim nga kursi i kembimit", sepse diferenca e kursit te kembimit ka qene e larte (fillimi i 2023 dhe fundi i 2023).
- Si pasojë e të ardhurave të konsiderueshme dhe shpenzimeve operative të reduktuara, aktiviteti ekonomik-operacional për vitin 2023 rezultoi +17.053 Mld. Lek fitim neto nga operacionet e vijueshëm, ose +16.3x më i lartë se PEF i Rishikuar prej vetëm 1.045 Mld. Lek. (gjithsesi rezultati është operativ dhe subjekt rishikimi dhe konsolidimi).

Realizimi operacional i aktivitetit për 2023, paraqitet grafikisht si më poshtë:

Grafiku 26. Pasqyra Operacionale të Ardhura/Shpenzime 2023 (‘000 Lek)



Edhe grafikisht për vitin 2023, pasqyrohet qartë aktiviteti komercial energjistik i shtuar me të ardhura të kënaqshme sipas zërave, gjithashtu edhe të ardhura financiare të rritura. Në krahun tjetër, vërehet aktivitet blerës energjistik me kosto të reduktuara, gjithashtu shpenzime të përgjithshme me vlera në efikasitet të kostove, por duke siguruar një aktivitet normal të operacioneve të vijueshëm.

Performanca pozitive e Shoqërisë gjatë vitit 2023, bëri që Qeveria Shqiptare/MIE mos të aktivizojë subvencionim buxhetor, i planifikuar si kontingjencë në buxhetin e shtetit 2023, në vlerë 12 Mld. Lek për KESH, duke dhënë efekt pozitiv direkt në buxhetin/arkën e shtetit.

- Në kuadër të veprimtarisë së operacioneve të vijueshëm, në terma afatshkurtër, treguesit e borxhit afatshkurtër-overdraft, paraqiten në tabelën vijuese:

**Tabela 13: Overdraftet dhe Normat e Interesit 2018-2023**

Overdraftet dhe Normat e Interesit	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Mesatarja 5-vjeçare (2018-2022)
<b>Totali i Huave të b.vlefshme ('000 Lekë)</b>	5,665,459	6,003,291	4,974,131	7,312,205	18,472,341	17,441,694	10,840,733
<b>Norma Mesatare e Interesave</b>	2.22%	3.21%	3.19%	2.88%	2.79%	4.43%	3.72%
<b>Shpenzimet për Interesa ('000 Lekë)</b>	126,036	192,817	158,891	377,020	516,084	772,792	403,521

Linja e borxhit afatshkurtër/overdrafteve, është ulur në 5.66 Mld. Lek. Ndërkohë, ekspozimi nga përdorimi i tij ka qenë edhe më i kufizuar, pasi Korporata siguroi flukse-hyrëse monetare nga aktiviteti energjistik. Si rezultat, shpenzimet për interesa për overdraft, janë në vlerën 126 Mln. Lek, më e ulët se perioda 2018-2022, duke ulur koston mesatare të interesave në 2.22%.

- Aktiviteti fiskal, përmbledhet në tabelën vijuese:

**Tabela 14: Aktiviteti dhe Kontributi fiskal 2018-2023**

Pagesat e Detyrimeve Tatimore (000 Lekë)	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Mesatarja 5-vjeçare (2018-2022)
<b>TVSH paguar te tatimet</b>	-	2,174	2,094,275	780,351	2,465,257	2,256,907	1,519,793
<b>Tatim fitimi</b>	1,150,010	304,230	1,563,342	1,766,673	2,629,879	2,343,988	1,721,622
<b>Sigurime shoqërore dhe shëndetësore</b>	361,180	340,217	344,107	302,049	274,126	253,902	302,880
<b>Taksa dhe Tarifa të tjera-Tatim në Burim</b>	1,811	1,425	6,511	824	6,116	3,934	3,762
<b>TOTAL</b>	1,513,000	648,047	4,008,235	2,849,897	5,375,378	4,858,731	3,548,057

Referuar tabelës, kontributi fiskal për vitin 2023, aktualisht rezulton mbi 1.5 Mld. Lek. Gjithsesi kjo vlerë është e përkohshme, pasi në zërin Tatim Fitimi, vlera është pjesore e parapaguar e këtij tatimi. Ndërkohë që me konsolidimin e pasqyrave financiare dhe si efekt i rezultatit pozitiv të veprimtarisë, ky tatim mund të shkojë deri në 3 Mld. Lek, duke rritur edhe më tej kontributin fiskal në buxhetin e shtetit. Zëri i detyrim TVSH, mbetet 0, pasi TVSH e paguar rezulton më e lartë se ajo e mbledhur.

## 7.2 MARRËDHËNIET BRENDA SEKTORIT ELEKTROENERGJETIK

Tashmë, tregu elektroenergjetik shqiptar me aktivizimin e bursës së energjisë, zgjerimin e sektorit privat dhe në tërësi ecurisë së reformave si liberalizimi i tregut sipas niveleve të tensionit, liberalizimi i pjesëve sipas produkteve, si tregu i balancimit, shërbimet ndihmëse etj., kanë shfaqur një panoramë të re. Gjithsesi, gjendja e emergjencës, përgjegjësia e sektorit publik veçanërisht KESH, OSHEE Grup dhe OST, shtuar kësaj edhe madhësinë e këtyre operatorëve, e bën sektorin publik forcën kryesore në performancën kombëtare të sektorit. Për rrjedhojë, marrëdhëniet financiare brenda sektorit publik, për shkak të balancave të konsiderueshme (pasojë e një gjendje të historike të krijuar), ndikon ndjeshëm në likuiditetin, soliditetin financiar dhe zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë të KESH sh.a.. Gjendja dhe balancat e marrëdhënieve ekonomiko-financiare për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

**A. Detyrimet financiare të OSHEE Grup sh.a. ndaj KESH sh.a.**

- Shlyerja e detyrimeve financiare korente për blerje energjie nga ana e FSHU/OSHEE Group sh.a. për periudhën Janar- Dhjetor 2023, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 15. Detyrimet për faturat e energjisë elektrike të FSHU sh.a. ndaj KESH sh.a. 2023**

Viti 2023	Faturimi mujor (lekë)	Arkëtimi mujor (lekë)	% e Arkëtitimit ndaj Faturimit
Janar	2,532,197,760	1,435,802,240	56.7%
<b>Shkurt</b>	<b>3,175,350,360</b>	<b>6,145,193,958</b>	<b>193.5%</b>
Mars	1,656,347,374	2,224,932,840	134.3%
<b>Prill</b>	<b>902,287,440</b>	<b>0</b>	<b>0.0%</b>
Maj	606,569,040	900,000,000	148.4%
<b>Qershor</b>	<b>421,715,760</b>	<b>0</b>	<b>0.0%</b>
Korrik	1,414,179,138	0	0.0%
<b>Gusht</b>	<b>2,031,206,574</b>	<b>0</b>	<b>0.0%</b>
Shtator	1,574,868,208	0	0.0%
<b>Tetor</b>	<b>1,059,984,422</b>	<b>1,527,760,414</b>	<b>144.1%</b>
Nëntor	624,818,215	1,842,496,680	294.9%
Dhjetor	4,099,862,784	928,235,960	22.6%
<b>TOTAL</b>	<b>20,099,387,076</b>	<b>15,004,422,093</b>	<b>74.7%</b>

Nga tabela e mësipërme rezulton që arkëtimet e Korporatës nga FSHU, për furnizim DSHP rezultojnë në masën 74.7%. Përkundrejt faturimit, pagesat janë të ç'rregullta në kohë dhe vlerë. Kjo është dukuri e përsëritur. Për më tepër, të ardhurat e Korporatës nga arkëtimi për energji për shërbimin publik, zënë një pjesë të konsiderueshme të shifrës së afarizimit. Kjo sjell rritje të llogarive të arkëtueshme, duke reduktuar cash-flown operativ hyrës, dhe nivelin likuiditetit të KESH.

- Gjendja e detyrimeve financiare të akumuluar në fund të vitit 2023, të OSHEE/FSHU sh.a. ndaj KESH sh.a. të cilat klasifikohen si “Llogari të arkëtueshme/Klientë” për Korporatën, situata agregate deri më 31 Dhjetor 2023, paraqitet në tabelën si vijon:

**Tabela 16. Detyrime të akumuluar të OSHEE/FSHU sh.a. ndaj KESH sh.a. 31 Dhjetor 2023**

Llogaritë e Arkëtueshme me FSHU/OSHEE Grup	31 Djetor 2023	31 Djetor 2022	Ndryshimi 2023 vs 2022		Pesha brenda llogarive të arkëtueshme (31.12.2023)
	(lekë)		(%)		(%)
<b>Detyrimet e Prapambetura të OSHEE Grup</b>					
Fatura për mbulimin e humbjeve	2,537,190,158	2,537,190,159	-1	0.00%	4.2%
Fatura për energjinë e klientëve tariforë (prodhimi vendas) OSHEE	28,135,231,197	29,435,231,197	-1,300,000,000	-4.42%	47.0%
Fatura për penalitete	17,019,529,911	17,019,529,924	-13	0.00%	28.4%
Fatura për energji elektrike nga importi	0	0	0	0.00%	0.0%
Detyrim për transferim asetesh	17,400,414	17,400,414	0	0.00%	0.0%
FSHU	12,200,654,655	6,856,771,959	5,343,882,696	77.94%	20.4%
<b>TOTAL</b>	<b>59,910,006,334</b>	<b>55,866,123,652</b>	<b>4,043,882,682</b>	<b>7.24%</b>	<b>100.0%</b>

Referuar tabelës së mësipërme, gjendja e llogarive të arkëtueshme është rritur me +4.04 Mld. Lek, ose +7% gjatë vitit 2023, duke e thelluar situatën negative të akumuluar. Kjo e gjitha vjen nga rritja e detyrimit të FSHU, i cili brenda vitit është rritur me gati 78%. Këto detyrime të akumuluar më 31.12.2023, zënë 20.4% të totalit të detyrimeve, duke u rritur me shpejtësi.

Theksojmë që pjesa më e madhe e grupit të detyrimeve mbi 47%, janë detyrime te prapambetura të OSHEE për energjinë e klientëve tariforë të akumuluar nga periudhat e mëparshme, pavarësisht uljes me -4.42% gjatë 2023. Po kështu mbetet e pandryshur pesha e faturave për penalite me 28.4% dhe ajo për mbulimin e humbjeve me 4.2%. Llogaritë e arkëtueshme (detyrim nga FSHU/OSHEE Grup), mbeten mjaft të larta në bilancin e Korporatës, duke përbërë mbi 79% të gjendjes së “Llogarive të Arkëtueshme/Klientë”, dhe me ndikim të ndjeshëm negativ në gjendjen financiare dhe aftësinë e saj paguese.

- Përsa i përket shlyerjes së detyrimeve për huatë afatgjata, në zbatim të marrëveshjes së nënshkruar më 10 Mars 2009 “Marrëveshja e Ripagimit të Kredive Afatgjata”, ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a), sot OSHEE Grup sh.a., e cila përmban dhe Aneksin 1 ku sipas skeduleve të çdo kredie të transferuar, janë përcaktuar vlerat e principaleve dhe interesave që duhen paguar në periudhat e caktuara, OSHEE/FSHU sh.a ka një detyrim korrent për periudhën vitin 2023, në vlerën mbi 498.5 Mln. Lek. Detyrimi i akumuluar sa vjen dhe rritet. Gjatë vitit 2023 nuk është kryer asnjë pagesë nga OSHEE për këto detyrime. Rrjedhimisht, deri më 30.12.2023, detyrimi i akumuluar i OSHEE për huatë afatgjata të transferuara është mbi 5.63 Mld. Lek (me kosto historike), sikurse ilustruar në tabelën vijuese:

**Tabela 17. Detyrimet e OSHEE ndaj KESH sh.a. për Huatë Afatgjata 31 Dhjetor 2023**

Detyrimi i OSHEE për huat e transferuara (lekë)	Gjendja më 31.12.2022 me kosto historike (leke)	Detyrime për pagesë Janar-Dhjetor 2023	Pagesa për periudhën Janar-Dhjetor 2023	Gjendja më 31.12.2023 me kosto historike (leke)
Detyrime për huat e transferuara	11,594,682,830			11,107,829,522
Pjesa afat-shkurtër - principal (detyrim)	4,291,163,884	441,959,788	-	4,733,123,672
Pjesa afat-shkurtër - interesa (detyrim)	841,112,021	56,600,842	-	897,712,863
<b>Pjesa afat-shkurtër - Total (detyrim)</b>	<b>5,132,275,905</b>	<b>498,560,629</b>	<b>-</b>	<b>5,630,836,535</b>

**B. Detyrimet Financiare të OST sh.a. ndaj KESH sh.a.**

Në lidhje me marrëdhëniet me OST sh.a. gjatë vitit 2023, mund të evidentojmë:

- Nga OST sh.a. janë shlyer detyrime korente të periudhës në shumën rreth 3.48 Mld. Lek për faturat e energjisë për shërbimet e dhëna nga KESH, që përbëjnë gati 70% të totalit të detyrimit vjetor prej 4.98 Mld. Lek. Ndërsa për detyrime të prapambetura gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar rreth 622 Mln. Lek. Më poshtë tabela përmbledhëse, sipas zërave:

**Tabela 18. Detyrimet e OST sh.a. ndaj KESH sh.a. për faturat korente 2023**

Detyrimet e OST sh.a. (lekë)	Faturim/Netim Janar-Dhjetor 2023	Arkëtim/Netim Janar-Dhjetor 2023	Arkëtim për detyrime të prapambetura
Fatura për humbjet në sistemin e transmetimit	811,634,429	811,634,429	225,350,412
Fatura për shërbimet ndihmëse	2,405,513,594	2,118,517,784	160,661,598
Fatura për disbalancat	50,402,281	53,669,804	120,000,000
Fatura për energji elektrike për aktivizim rezerve (balancim)	1,716,021,090	495,083,273	115,667,597
Fatura për penalitete (nese ka)			
<b>TOTAL</b>	<b>4,983,571,394</b>	<b>3,478,905,290</b>	<b>621,679,607</b>

- Ashtu si theksuam edhe më lart, moslikuidimi në kohë dhe pjesor ka krijuar detyrime të akumuluar nga OST sh.a. ndaj Korporatës për energjinë elektrike të furnizuar e faturuar kryesisht për shërbimin e aktivizim rezerve/balancim, i cili përbën 67.6%, të detyrimit total. Për rrjedhim, totali i këtyre detyrimeve agregate në fund të 2023 rezulton mbi 11.2 Mld. Lek. Gjithsesi vërehet që detyrimet e prapambetura për humbjet në transmetim janë ulur në gati -92% dhe për shërbimet në -80%. Referuar tabelës së mëposhtme, krahasuar me fundin e 2022, viti 2023 mbyllet me rritje të “Llogarisë së arkëtueshme/klientë” (për detyrime të akumuluar nga OST), me 7.6%. Kjo situatë ndikon negativisht në gjendjen e likuiditeteve të Korporatës dhe aftësinë paguese të saj. Llogaritë e arkëtueshme (detyrim nga OST sh.a.), përbëjnë rreth 15% të gjendjes së “Llogarive të Arkëtueshme/Klientë” në bilancin e Korporatës

**Tabela 19. Detyrimet e akumuluar të OST sh.a. ndaj KESH sh.a. 31 Dhjetor 2023**

Llogaritë e Arkëtueshme me OST sh.a. (lekë)	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022	Ndryshimi 2023 vs 2022		Pesha brenda llogarive të arkëtueshme (31.12.2023)
	(lekë)		(%)	(%)	(%)
Fatura për humbjet në sistemin e transmetimit	18,532,039	225,350,423	-206,818,384	-91.78%	0.2%
Fatura për shërbimet ndihmëse	284,000,659	157,666,448	126,334,211	80.1%	2.5%
Fatura për disbalancat	2,056,717,505	2,244,850,704	-188,133,199	-8.38%	18.3%
Fatura për energji elektrike për aktivizim rezerve (balancim)	7,594,275,877	6,527,258,337	1,067,017,540	16.3%	67.6%
Fatura për penalitete	1,283,100,142	1,283,100,142	0	0.00%	11.4%
<b>TOTAL</b>	<b>11,236,626,222</b>	<b>10,438,226,054</b>	<b>798,400,169</b>	<b>7.6%</b>	<b>100.0%</b>

- Për vitin 2023, detyrimi financiar i OST sh.a. për interesa dhe principal për huat afatgjata është në vlerën rreth 418.3 Mln. lekë. Për këtë periudhë nga ana e OST sh.a. është kryer pagesë vetëm 59 Mln. Lek, pra vetëm 14% e detyrimit korent. Kjo situatë e pandryshuar dhe e përsëritur ka rritur detyrimin e akumuluar të Huave Afatgjata të OST ndaj KESH nga 5.22 Mld. Lek në fund të 2022 në mbi 5.84 Mld. Lek në fund të vitit 2023. Si rrjedhim, situata e detyrimeve të akumuluar për huatë e transferuara afatgjata të pashlyera nga OST sh.a. deri më 31.12.2023, paraqitet në tabelën në vijim:

**Tabela 20. Detyrimet e OST sh.a ndaj KESH sh.a. për Huatë Afatgjata 31 Dhjetor 2023**

Detyrimi i OST për huat e transferuara (lekë)	Gjendja më 31.12.2022 me kosto historike (leke)	Detyrime për pagesë Janar-Dhjetor 2023	Pagesa për periudhën Janar-Dhjetor 2023	Gjendja më 31.12.2023 me kosto historike (leke)
Detyrime për huat e transferuara	8,399,624,795			8,024,585,898
Pjesa afat-shkurtër - principal (detyrim)	4,546,858,482	354,418,114	51,526,506	4,849,750,090
Pjesa afat-shkurtër - interesa (detyrim)	678,751,095	63,857,939	7,529,202	735,079,832
<b>Pjesa afat-shkurtër - Total (detyrim)</b>	<b>5,225,609,576</b>	<b>418,276,053</b>	<b>59,055,708</b>	<b>5,584,829,922</b>

**C. Detyrime të KESH sh.a. Huatë Afatgjata**

- Vlera agregate e huave afatgjata më 31.12.2023 të KESH, kap shumën kap vlerën 72.66 Mld. Lek, duke u ulur me -7%, krahasuar me fundin e 2022 prej 77.72 Mld. Lek. Gjithashtu gjatë vitit 2023, janë disbursuar hua në vlerë 868 Mln. Lek, disbursime pothuajse të gjitha nga KfW, por edhe SECO, që i përkasin “Projektit të Sigurisë së Digave” dhe Rehabilitimit E-M të HEC Fierzë. Në vijim, tabela e detyrimeve të Korporatës për Huatë Afatgjata:

**Tabela 21. Detyrimet e KESH sh.a. për Huatë Afatgjata 31 Dhjetor 2023**

Detyrimi i KESH për huatë afatgjata (lekë)	Gjendja më 31.12.2022 me kosto historike (lekë)	Disbursime Janar-Dhjetor 2023	Detyrime për pagesë Janar-Dhjetor 2023	Pagesa për periudhën Janar-Dhjetor 2023	Gjendja më 31.12.2023 me kosto historike (lekë)
<b>Detyrime për huat afatgjata</b>	77,719,386,381	868,283,446			72,660,717,121
Pjesa afat-shkurtër - principal (detyrim)	28,071,934,008		6,348,458,660	1,964,113,225	32,456,279,443
Pjesa afat-shkurtër - interesa (detyrim)	3,908,998,286		1,371,830,712	546,144,007	4,734,684,990
<b>Pjesa afat-shkurtër - Total (detyrim)</b>	<b>31,980,932,295</b>		<b>7,720,289,371</b>	<b>2,510,257,232</b>	<b>37,190,964,433</b>

Referuar tabelës së mësipërme, Korporata ka kryer pagesa rreth 2.51 Mld. Lek principal+interesa të periudhës, një vlerë e konsiderueshme, por që përbën vetëm 1/3 (33%) e detyrimit korent të periudhës prej rreth 7.72 Mld. Lek. Si rezultat, ekspozimi i KESH sh.a. ndaj Ministrisë së Financave për huatë afatgjata (principal dhe interesa) të maturuara deri më 31 Dhjetor 2023, kap vlerën 37.19 Mld. Lek duke u rritur me 16%, krahasuar me fundin e 2022 kur detyrimi ishte rreth 31.98 Mld. Lek.

Në shumën e këtij detyrimi përfshihen edhe detyrimet e akumuluar për huatë afatgjata të transferuara të pashlyera nga OSHEE sh.a në vlerën rreth 5.63 Mld. Lek dhe OST sh.a. në vlerën 5.58 Mld. Lek. Pra, rritja e detyrimeve për huatë vjen edhe për shkak të shoqërive të sistemit OSHEE Grup sh.a. dhe OST sh.a., të cilat nuk kryejnë pagesat, ose në rastin më të mirë kryejnë pagesa jo të plota për detyrimet e prapambetura të këtyre huave, duke reflektuar vështirësi likuidimi tek Korporata, e cila mbetet titullare e këtyre huave ndaj MF. Pavarësisht situatës pozitive ekonomike gjatë vitit 2023 dhe pagesave ndaj detyrimeve afatgjata, për shkak të situatës historike endemike të detyrimeve të akumuluar që bllokojnë likuiditetet e nevojshme, Korporata e ka ende të vështirë, likuidimin e detyrimeve në tërësi, pa mbështetjen e buxhetit të shtetit.

**8. KONKLUZIONE**

Referuar performancës së aktivitetit në 2023, zhvillimeve/ngjarjeve në sektorin Elektroenergjetik dhe nën optikën e parashikimeve për 2024, konkluzionet kryesore janë:

- Viti 2023 përshkruhet si një vit pozitiv ushtrimor, ku aktiviteti operacional i Korporatës përballoi me sukses sfidat dhe përgjegjësitë në përballimin gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji. Edhe gjatë vitit 2023 Korporata kishte detyrimin që gjatë gjendjes së emergjencës të siguronte të gjithë energjinë elektrike e nevojshme për FSHU sh.a. për përmbushjen e detyrimit ndaj klientëve universal, klientëve tariforë FMF si dhe sasia e tepërt për OSSH për mbulimin e humbjeve në shpërndarje. Në kushtet e emergjencës, por ndryshe nga viti i vështirë 2022, kjo përgjegjësi dhe arritja e këtij objekti madhor u përballua më mirë, si rezultat i situatës hidrike të favorshme dhe tregjeve globale më të stabilizuara. Në këto kushte, Korporata, arriti të përmbush me sukses këtë përgjegjësi nëpërmjet prodhimit të brendshëm të shtuar, depozitim/shkëmbimit të energjisë

veçanërisht me KEK, menaxhimit efikas të depozitimeve nga PPE për mbulimin e humbjeve në shpërndarje, duke patur ekspozim të ulët ndaj tregjeve të energjisë. Për më tepër, Shoqëria pati mundësinë dhe volumet e energjisë, për kryerjen e aktivitetit komercial energjie në tregun, duke qenë mjaft aktive, për sigurimin e të ardhurave shtesë nga tregtia e energjisë. Duhet theksuar, që ky aktivitet gjatë 2023, jo vetëm prodhoi rezultate pozitive në operacionet e vijueshëm, por bëri që Shoqëria të mos kishte nevojë për aktivizimin e mbështetjes financiare nga Qeveria, duke dhënë kështu një kontribut direkt, në buxhetin e shtetit.

- Në aspektin hidrik, viti 2023, konsiderohet një vit i favorshëm. Referuar indikatorëve kryesor si prurje, nivel shfrytëzimi, prodhim dhe rezervë energjitike ai paraqitet mjaft më optimal se vitet e jo të favorshme 2019, 2020 dhe 2022 dhe i ngjashëm me vitet pozitive 2018 dhe 2021. Eventet e reshjeve dhe prurjet kanë qenë optimale, konstante, pa krijuar amplituda të forta, duke i dhënë mundësi Shoqërisë të menaxhojë situatën hidrike dhe treguesit e tjerë të operimit në mënyrë efikase. Kjo u arrit nëpërmjet kombinimit të parashikimeve hidro-meteorologjike të sakta dhe planeve të operim/shfrytëzimit eficiente dhe të balancuara. Korporata administroi, operoi dhe shfrytëzoi kapacitetet hidrike në mënyrë mjaft racionale, për të prodhuar maksimumin e mundshëm të energjisë, dhe njëkohësisht për të ruajtur prametrat optimal të niveleve të shfrytëzimit dhe rezervës energjitike. Për rrjedhojë, kjo ndikoi në volumet shtuara të prodhimit të brendshëm, duke përballuar më lehtë përgjegjësitë ndaj DSHP dhe ulur ekspozimin ndaj tregut të lirë/importeve. Po kështu, në funksion të rritjes së gjenerimit, asetet termike lundrues me fuqi 110 MW, janë gjithashtu një garanci në prodhim sidomos për periudhat e thata, duke rritur dhe optimizuar profilin e prodhimit të brendshëm.
- Gjatë vitit 2023, Programi Ekonomiko-Financiar i Korporatës u hartua në përshtatje me situatën e emergjencës, me fokus kryesor përmbushjen sasiore të DSHP-së dhe me skenarët përkatës të përballimit të kësaj situate. Theksi u vu kryesisht mbi aktivitetin në tregun e rregulluar dhe përmbushjen e DSHP. Gjithshtu u planifikua aktivitet komercial më dinamik. Shpenzimet e përgjithshme operacionale u parashikuan të matura, sipas principeve të optimizimit dhe efijencës së kostove. Në lidhje me investimet, u planifikuan sipas objektivave kryesor si siguria e asetëve gjeneruese, rritja e efijencës në prodhim, shtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese dhe infrastruktura e TIK. Si rezultat e ecurisë pozitive, PEF u rishikua në mesin 2023, duke përditësuar dhe përshtatur planet e aktivitetit operativ dhe investues me objektiva më të përmirësuara.
- Aktiviteti tregtar gjatë 2023, u orientua ndaj sigurimit të sasive të energjisë për plotësimin e DSHP-së (tregu i rregulluar), si prioritet kryesor dhe të parashikuara në kuadrin ligjor/rregullator të situatës së emergjencës dhe me prioritet ekspozimin sa më minimal ndaj importit të energjisë me çmime të shtrenjta. Gjithashtu, u mundësuan dhe u shtuan edhe aktivitetet e tjera komerciale si shitja e energjisë në kushtet e prurjeve, optimizimi ekonomik, shërbimet e balancimit dhe shkëmbimi i energjisë në funksion krijimin e të ardhurave komerciale shtesë;
- Në rrafshin operativo-ekonomik, viti 2023 rezultoi me fitim të konsiderueshëm, duke regjistruar një rezultat mjaft pozitiv dhe në kontrast të plotë me vitin 2022. Në vija të përgjithshme, ecuria pozitive në 2023, tregon aftësinë/potencialin e lartë reagues dhe rikuperues që bart Korporata, në përballimin e situatave të tilla, veçanërisht atë të rritjes galopante së çmimeve të energjisë në tregje globale. Gjithsesi, kjo ecuri pozitive e 2023 krahasuar me 2022, tregoi përsëri se portofoli gjenerues aktiv pothuajse 100% hidro, shfaq varësinë e ndjeshme të aktivitetit operacional të Shoqërisë ndaj kushteve hidro-meteorologjike, duke ndikuar ndjeshëm në qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë rezultateve ekonomike pozitive dhe stabilitetin/konsolidimin financiar.
- Në aspektin e objektivit strategjik të shtimit të diversifikuar të kapaciteteve gjeneruese, pas fillimit operimit në 2022 të impiantit PV diga Qyrfaq/HEC ViD me fuqi 5.14 MW, si kapaciteti i parë i diversifikuar i energjisë, që iu shtua asetëve gjeneruese të Korporatës, viti 2023 (pavarësisht gjendjes së emergjencës emergjencës), shënoi ecuri të kënaqshme në hapat zhvillimore të BRE si impianti PV Lundrues/Vau i Dejës, PV Diga e Zadejës/Vau i Dejës, PV Belsh dhe Projekti HEC Skavica;

- Në lidhje me liberalizimin e modelit të tregut të energjisë dhe reformave sektoriale, viti 2023 shënoi ngjarjen më të rëndësishme pasi nisi operimin zyrtar Bursa Shqiptare e Energjisë - ALPEX, përmes ankandit të parë të tregut të ditës në avancë (DAM), duke realizuar një nga përparësitë e Qeverisë së Shqipërisë për sektorin energjistik një angazhim i realizuar të Shqipërisë ndaj Sekretariatit të Komunitetit Europian të Energjisë. Operimi i ALPEX, i ka dhënë sektorit elektroenergjitik një nivel tjetër të funksionimit të tregut, duke e përafruar dhe integruar më tepër me tregjet e zhvilluara evropiane të energjisë. ALPEX synon të jetë NEMO me shtrirje rajonale, duke filluar me unifikimin e tregut me Kosovën. Në aspektin tregtar, si një pjesëmarrës aktiv në ALPEX, shumë aktivitete komerciale të Korporatës, u kryen nëpërmjet ALPEX duke sjellë standarte të larta shkëmbimi, transparencë dhe siguri në transaksion.

Viti 2024 e gjen sektorin dhe tregun elektroenergjitik në përgjithësi dhe KESH sh.a. në veçanti në kushte më normale aktiviteti, pasi gjendja së emergjencës në sektor shfuqizohet, si rezultat i uljes dhe stabilizimit të çmimeve globale.

Indeksi mesatar base-load i HUPX për periudhën Janar-Shkurt 2024, ka zbritur në mesatarren 78.63 Eur/MWh. Përsa i përket së ardhmes afatshkurtër, referuar të dhënave të HUDEX mbi kontratat derivative të së ardhmes, aktualisht parashikohet që indeksi baseload për periudhën 2024-2025 të jetë më së shumti brenda fashës 60-80 Eur/MWh, duke projektuar stabilitet në çmimet e energjisë. Gjithsesi edhe këto parashikime janë mjaft evazive, pasi situata delikate gjeopolitike, veçanërisht vazhdimi i konfliktit Rusi-Ukrainë, krijon pasiguri të lartë në projeksione.

Në tregun e brendshëm gjatë 2024, priten zhvillime të rëndësishme. Në vijim të aktivitetit të ALPEX, tregjet e energjisë të Shqipërisë dhe Kosovës unifikohen në ALPEX. Po kështu ALPEX, së shpejti do të implementojë edhe opsionin/procedurën intraday (IDM) për tregtim të energjisë elektrike.

Gjithashtu prej datës 1 Janar 2024, konsumatorët e lidhur në nivel tensioni 20 kV dalin në treg të lirë, duke dhënë efekt të dyfishtë pozitiv në aktivitetin komercial të Korporatës, pasi lehtëson Korporatën për ulje të DSHP. Për më tepër, liberalizimi i tregut për fashën e tensionit 20 kV, krijon oportunitet biznesi (duke shfrytëzuar licencën për furnizimin me pakicë) për ofrimin e furnizimit nga KESH, ndaj këtij segmenti konsumatorësh.

Në përfundim, falë edhe vizionit të stafit drejtues për zhvillimin e qëndrueshëm të Korporatës dhe mbështetjes së madhe të Qeverisë Shqiptare, objektivat e KESH sh.a., si prodhuesi më i madh dhe me përgjegjësi publike, mbeten të fokusuara në këto drejtime:

1. Garantimin e furnizimit për detyrimin e shërbimit publik, sipas kuadrit ligjor dhe rregullator;
2. Rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të veprave të mëdha energjetike, në Kaskadën e Drinit nëpërmjet rinovimeve të vazhdueshme kapitale dhe modernizimit teknologjik;
3. Shtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese (kryesisht PV, por jo vetëm), për diversifikimin e portofolit gjenerues nëpërmjet Burimeve të Rinovueshme të Energjisë. Kjo strategji zhvillimore jo vetëm do fillojë të ulë varësinë e prodhimit nga forma hidro, por kombinimi i të dyjave do të sillte optimizim të rezervës energjetike, nëpërmjet operimit hibrid të burimeve gjeneruese, me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga aktiviteti komercial;
4. Komercializimi i mëtejshëm i aktivitetit ekonomik, nëpërmjet sjelljes proaktive, pjesëmarrëse në treg, shtrirja e mëtejshme të aktivitetit në nivelin rajonal, si dhe modernizimit/digjitalizimit të procedurave të tregut të energjisë elektrike;
5. Transformimi i vazhdueshëm i Korporatës drejt qasjes adekuate ndaj tregut në transformim drejt liberalizimit, nëpërmjet orientimit të burimeve njerëzore drejt metodave dhe stilit të punës në skuadër, rritjes së performancës/produktivitetit dhe qasja drejt praktikave më bashkëkohore të zhvillimit të biznesit dhe teknologjisë/digjitalizimit.